

Censi i Popullsisë dhe Banesave të Shqipërisë

Dokumenti i Strategjisë dhe Planifikimit

Përgatitur nga INSTAT, Instituti Kombëtar i Statistikave të Shqipërisë në bashkëpunim me ekspertët ndërkombëtarë

Versioni 1.2
Tiranë, 20 Prill 2018
Rishikuar, Qershor 2021

Mbështetur nga: Swiss Development Cooperation, Ambasada e Zvicrës, Tiranë; Zyra Federale e Statistikave Suedeze (FSO), Projekti SALSTAT (Strong Albanian Local Statistics)

Përmbledhja e lëndës

Përmbajtja

Impakti i Covid – 19 në aktivitetet e Cens të Popullsisë dhe Banesave	6
Përmbledhje ekzekutive	6
1.1 Qëllimi i dokumentit	8
1.2 Konteksti politik, ekonomik, social dhe kërkesa për të dhëna.....	8
1.3 Sistemi i statistikave shqiptare dhe roli i INSTAT	9
1.4 Rëndësia e mbështetjes nga donatorët	9
2. Objektivat e Censit të Popullsisë dhe Banesave.....	10
2.1 Kërkesat dhe rekomandimet ndërkombëtare	10
2.2 Ndryshimet në metodologjinë e Censit.....	11
2.3 Mësimet e nxjerra nga censi i popullsisë dhe banesave 2011.....	12
2.5 Objektivat strategjike të Censit të Popullsisë dhe Banesave.....	13
3. Legjislacioni i Censit	15
3.1 Ligji I Censit	15
3.2 Kalendar i punës për legjislacionin.....	15
3.3 Përafrimi me legjislacionin e BE-së	15
4. Komunikimi dhe fushata publicitare.....	17
4.1 Objektivat.....	17
4.2 Grupet e synuara	18
4.3 Mjetet e komunikimit.....	18
4.4 Kohëzgjatja dhe modulimi	18
4.5 Mbështetja e jashtme.....	19
5. Menaxhimi dhe organizimi i Censit.....	19
5.1 Organizimi i Censit	19
5.2 Njësia e Censit pranë INSTAT	20
5.3 Struktura organizative e INSTAT për Censin.....	21
6. Metodologjia e censit 2020	22
6.1 Parimet metodologjike	22
6.1.1 Përgatitja për censin bazuar në regjistra	23
6.2 Modalitetet dhe mënyra e numërimit.....	24
6.2.1 Vendbanimi i zakonshëm.....	24
6.2.2 Popullata që do të regjistrohet.....	25
6.2.3 Data e referencës dhe kohëzgjatja e cens në terren.....	25
6.2.4 Mënyra e mbledhjes së të dhënave	25
6.2.5 Të anketuarit	25
6.2.6 Modaliteti i intervistës	25
6.2.7 Adminstrimi i pyetësorëve	25
6.2.8 Popullata në institucione	26
6.3 Përmbajtja e pyetësorëve	26
6.4 Sensitiviteti ndaj gjinisë	27
6.5 Dokumentet teknike	28
6.6 Testet dhe Censi Pilot	28
6.6.1 Testet.....	29
6.6.2 Censi pilot	29
6.7 Garantimi i cilësisë	31
6.7.1 Menaxhimi i riskut.....	32

6.8	Anketa Pas Censit (APC).....	32
6.8.1	Objektivat.....	32
6.8.2	Metodologjia e APC	33
6.8.3	Plani i kampionit.....	33
6.8.4	Stafi në terren.....	33
6.8.5	Përdorimi i të dhënave	34
7.	Gjeografia e Censit dhe informacioni gjeohapësinor	34
7.1	Rëndësia ndër-sektoriale e të dhënave gjeohapësinore.....	34
7.2	Një strategji e Gjeografisë së Censit të ardhshëm dhe më tej.....	35
7.3	Aktivitetet e Gjeografisë së Cens-it në fazën e para-numërimit	36
7.3.1	Përkufizimi i gjeografisë së Cens	36
7.3.2	Rezultatet paraprake të përditësimit të hartës	37
7.3.3	Shtyrja e Regjistrimit dhe ndikimi në bazën e të dhënave.....	38
7.3.4	Përditësimi kompjuterik i GIS	39
7.3.5	Përgatitja e terrenit për një regjistër ndërtesash dhe banesash.....	39
7.4	Aktivitetet e Gjeografisë së Censit në fazën e numërimit.....	40
7.5	Aktivitetet e Gjeografisë së Cens-it në fazën pas Cens	40
8.1	Organizimi i censit në terren.....	41
8.1.1	Zyrat rajonale	42
8.1.2	Kategoritë e stafit në terren.....	42
8.1.3	Komisionet bashkiake	43
8.1.4	Komunikimi në terren	43
8.1.5	Numrat dhe shpërndarja e stafit anketues	43
8.2	Trajnimi.....	44
8.2.1	Strategjia e trajnimit.....	44
8.2.2	Ambientet e trajnimit	45
8.3	Puna në terren për censin	46
8.3.1	Detyrat e anketuesve	46
8.3.2	Kontrolli dhe mbikëqyrja	46
8.3.4	Monitorimi i progresit.....	47
8.3.5	Vlefshmëria e të dhënave të mbledhura.....	48
9.	Teknologjia e informacionit dhe përpunimi i të dhënave.....	49
9.1	Historik	49
9.2	Fizibiliteti i mbledhjes së të dhënave me CAPI.....	49
9.2.1	Konsideratat e infrastrukturës	49
9.2.2	Parashikime buxhetore	52
9.2.3	Përfitimet dhe risqet e CAPI kundrejt PAPI.....	53
9.2.4	Gatishmëria institucionale	55
9.2.5	Kalendari i cens.....	56
9.3	Infrastruktura e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) për CAPI	56
9.3.1	Sinkronizimi i të dhënave dhe infrastruktura e serverave.....	56
9.3.2	Transferimi i të dhënave me CAPI gjatë punës në terren	57
9.4	Siguria e të dhënave	58
9.5	Zhvillimi i aplikacionit për mbledhjen e të dhënave	59
9.5.1	Zgjidhjet e standatizuara e programeve kompjuterike.....	59
9.5.2	Filtrimi i pyetjeve dhe kalimi i pyetjeve me përgjigje të kushtëzuara.....	60

9.5.3	Validimi i të dhënave	60
9.5.4	Ngarkimi paraprak i pyetësorit me të dhënat administrative dhe kodet gjeografike.....	60
9.5.6	Ndihma në ekran	61
9.6	Sistemet e manaxhimi dhe monitorimit	61
9.6.1	Moduli i mbikëqyrësve të bashkisë.....	61
9.6.2	Moduli i kontrollorit	62
9.6.3	Moduli i anketuesit	62
9.7	Testimi i sistemit të mbledhjes së të dhënave.....	62
9.8	Mbështetja nga TI për anketuesit dhe mbikqyrësit gjatë punës në terren.....	63
9.9	Editimi dhe përpunimi i të dhënave	63
10.	Shpërndarja dhe analiza e rezultateve të Censit.....	64
10.1	Mbrojtja e të dhënave kofidenciale.....	65
10.2	Planet standarte të tabulimit dhe metadatave.....	65
10.2.1	Programi standart për tabelat shumëdimensionale (cross tabulation) të të dhënave të Cens	65
10.2.2	Programi standart për tabelat shumëdimensionale historike dhe indikatorët e ndryshimit	65
10.2.3	Tabelat shumëdimensionale sipas kërkesave të BE.....	65
10.3	Kërkesat ad hoc dhe aksesit në mikrodata	65
10.4	Analiza tematike dhe raportet	66
10.5	Media e shpërndarjes	67
10.6	Aftatet e shpërndarjes	67
11.	Logjistika, prokurimi dhe rekrutimi	67
11.1	Hapësirat e zyrave.....	68
11.2	Materialet dhe pajisjet.....	68
11.2.1	Prokurimi	68
11.2.2	Menaxhimi i materialeve dhe pajisjeve	68
11.2.3	Menaxhimi i pajisjeve të mbledhjes së të dhënave.....	68
11.2.4	Mirëmbajtja dhe riparimi i pajisjeve kompjuterike	69
11.2.5	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjetit.....	69
11.3	Rekrutimi i stafit	69
11.3.1	Kategoritë e stafit të Cens	69
11.3.2	Procesi i rekrutimit.....	69
11.3.3	Rekrutimi i stafit numëruar.....	69
11.3.4	Kuadri ligjor që drejton personelin	70
11.3.5	Shpërblimi i stafit.....	70
11.3.6	Identifikimi i stafit	71
12.	Buxheti dhe kronologjia e aktiviteteve	71
13.	Qëndrueshmëria e Censit 2020.....	71
13.1	Infrastruktura dhe kapacitetet e TI-së	71
13.2	Hartografia dhe të dhënat gjeohapsinore	72
13.3	Koherenca e sistemit statistikor	72

Tabelat

Tabela 1: Temat mbi të cilat janë kërkuar të dhënat dhe Rregullorja e zbatimit të KE-së nr. 217/543

Tabela 2: Numri i stafit në terren gjatë fazës së regjistrimit

Tabela 3: Numri i stafit të terrenit sipas bashkive

Tabela 4: Kosto e përlogaritur e TI, nevojat për trajnim, materiale dhe pajisje, PAPI kundrejt CAPI

Tabela 5: Përfitimet dhe risku: PAPI kundrejt CAPI

Tabela 6: Përfitime shtesë të CAPI

Tabela 7: Buxheti i censit dhe grupi i aktiviteteve në vite, në Euro

Tabela 8: Buxheti i Censit me grupe aktivitetsesh dhe vite, në përqindje

Tabela A1: Dimensionet e sigurimit të cilësisë së censit të vitit 2021

Tabela A2: Specifikimet teknike për servera, tableta, laptopë për Censin

Figurat

Figura 1: Organizimi i Censit

Figura 2: Shpërndarja e Zonave të Numërimit për Cens Pilot

Figura 3: Organizimi i numërimit të Censit

Figura 4: Fortësia e sinjalit të rrjetit celular në Shqipëri

Figura 5: Koha e shpenzuar në Wi-Fi në Shqipëri dhe vendet fqinje

Impakti i Covid – 19 në aktivitetet e Cens të Popullsisë dhe Banesave

INSTAT analizoi situatën aktuale pandemike të COVID-19 për të kuptuar më mirë ndikimin e pandemisë në veprimtaritë e ndryshme statistikore dhe më konkretisht, në Censin e Popullsisë dhe Banesave.

Kriza COVID-19 krijon sfida të paprecedentë dhe të papritura për INSTAT për kryerjen e Censit të Popullsisë dhe Banesave duke detyruar të zhvillojë dhe miratojë me shpejtësi aktivitetet e Censit veçanërisht mbi trajnimin dhe mbledhjen e të dhënave. Kriza COVID -19 ka shkaktuar një pezullim të përkohshëm të aktiviteteve të kontratës së asistencës teknike për veprimtaritë e regjistrimit. INSTAT ka filluar punën për të adoptuar punën në mbrojtje të shëndetit të punonjësve duke kombinuar punën në institucion dhe atë në distance, online. Struktura e aksesit në distancë (SIMONA) po përdoret për të lehtësuar punën në distancë nga stafi i INSTAT dhe ekspertët e asistencës teknike. Për të siguruar cilësinë e Censit në këto kushte, INSTAT ka rishikuar strategjinë, riskun, planin e aktiviteteve dhe buxhetin e Censit.

Përmbledhje ekzekutive

- INSTAT në kushtet e krijuara nga ngjarjet e ndodhura si rezultat i forcave madhore, Tërmeti 2019 dhe Covid-19, propozoi shtyrjen e Censit me një vit kalendarik.
- INSTAT po punon të kryejë Censin e ardhshëm të popullsisë dhe banesave në tetor 2021. Strategjia paraqet planin operacional dhe planin mbështetës, duke përfshirë, buxhetin sipas vitit, grupin e aktiviteteve dhe kategorinë e shpenzimeve.
- Censi do të jetë plotësisht në përputhje me rekomandimet ndërkombëtare dhe rregulloret e BE-së. INSTAT do të përgatisë një ligj të rishikuar të Censit që do të miratohet në Parlamentin e Shqipërisë, në harmoni me ligjin e ri "Për statistikën zyrtare", rregulloret e BE-së dhe strukturën e ndryshuar territoriale dhe administrative të Shqipërisë.
- Censi do të përmirësojë koherencën e Sistemit Statistikor Shqiptar, duke hapur rrugën për krijimin e një regjistri të popullsisë rezidente dhe të ndërtesave dhe banesave, për qëllime statistikore dhe përdorimin e të dhënave administrative për statistikën e rregullta të popullsisë dhe banesave pas vitit 2021.
- INSTAT do të organizojë Censin dhe përditësojë infrastrukturën gjeohapësinore, duke rishikuar gjeografinë e Censit, përfshirë identifikimin e vendndodhjes së saktë të ndërtesave dhe banesave në të gjitha zonat e cens.
- Censi do të investojë në teknologjinë e informacionit dhe do të kryejë hartografinë dhe regjistrimin në terren me aplikacionet në tableta. Strategjia analizon fizibilitetin e Censit CAPI në Shqipëri dhe përshkruan përfitimet, rreziqet dhe investimet e nevojshme. Të gjitha hapat dhe masat e nevojshme që do të ndërmerren për të siguruar konfidencialitetin e të dhënave gjatë procesit të regjistrimit, gjatë përpunimit të të dhënave dhe shpërndarjes së tyre.

- Krahasuar me Censin e vitit 2011, numri i anketuesve dhe kontrollorëve në terren do të reduktohet në 6'000 (nga rreth 12'000), por kohëzgjatja e punës në terren do të zgjerohet nga katër në gjashtë javë. Kjo do të lejojë një proces selektiv të rekrutimit dhe do të reduktojë kostot e pajisjeve (tabletave).
- INSTAT ka përcaktuar një strukturë organizative të projektit të Cens, duke përfshirë Zyrat Rajonale të INSTAT-it, Zyrat Bashkiake dhe Komisionet Bashkiake. Roli i INSTAT-it do të forcohet për të siguruar që Cens kryhet si një operacion i pavarur dhe profesional.
- INSTAT do të përgatisë një fushatë komunikimi dhe publiciteti dhe do të organizojë workshope konsultimi me grupet e interesuara, për të diskutuar nevojat e përdoruesve në lidhje me pyetësin e censit, si edhe strategjinë e shpërndarjes së të dhënave, pas mbledhjes të tyre. Prioritet gjatë shpërndarjes së rezultateve do t'ju jepen të dhënave në nivel bashkiak, të mështetur nga teknologjia GIS.
- Kostoja gjithsej e Censit të Popullsisëpërlllogaritet rreth 16.4 milion Euro. Kjo përfaqëson 5.7 euro për frymë të popullsisë shqiptare që korrespondon ekzaktësisht me mesataren evropiane për Censet tradicionale. Mbi 50% të vlerës janë shpenzime të stafit, por shumë komponentë të buxhetit janë investime afatgjata për një sistem statistikor më të qëndrueshëm të Shqipërisë.

1. Hyrje

1.1 Qëllimi i dokumentit

Në korrik 2017, INSTAT mbajti mbledhjen e parë të Grupit Koordinues të Donatorëve për Censin e Popullsisë dhe Banesave.. Në mbledhjen e dytë të donatorëve, mbajtur më 6 tetor 2017, INSTAT paraqiti draftin e parë të projektit për Censin e Popullsisë dhe Banesave 2021, duke përfshirë një projekt-buxhet. Në takim u sugjerua që elementët më të rëndësishëm të projektit duhet të zhvillohen dhe detajohen më tej INSTAT, me mbështetjen e Bashkëpunimit Zviceran për Zhvillim dhe Zyrës Federale të Statistikave Zvicerane, mbledhi një grup ekspertësh për të hartuar një strategji dhe plan më të hollësishëm të Censit të Popullsisë, i cili reflekton më së mirë standardet dhe përvojat ndërkombëtare. Ekspertët dhe stafi i INSTAT u takuan në 12-16 mars dhe në 12-13 prill 2018 për të hartuar së bashku në dokumentin aktual.

Dokumenti përshkruan strategjitë dhe momentet kryesore, si dhe kërkesat ligjore, teknologjike, operacionale, dhe buxhetore për Censin e Popullsisë dhe Banesave, Në këtë mënyrë, kjo strategji duhet të ndihmojë qeverinë dhe parlamentin shqiptar, bashkësinë ndërkombëtare të donatorëve dhe INSTAT-in për të vendosur mbi angazhimet e tyre në mbështetjen dhe zbatimin e Cens në vitet në vijim.

1.2 Konteksti politik, ekonomik, social dhe kërkesa për të dhëna

Censi i fundit i Popullsisë dhe Banesave i Shqipërisë është kryer me sukses në tetor 2011. Që atëherë, kushtet politike, ekonomike dhe sociale në vend kanë evoluuar. Në vitin 2014, Këshilli European i dha Shqipërisë statusin e vendit kandidat dhe Shqipëria vazhdon të zbatojë detyrimet e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Në vitin 2015, Shqipëria kreu Reformën Territoriale dhe Administrative, e cila riorganizoi qeveritë lokale dhe krijoi 61 Bashki, nga ish 65 Bashki dhe 308 Komuna. Në të njëjtën kohë, Bashkitë e reja morën kompetenca dhe funksione të reja, si edhe instrumente të pjesëmarrjes dhe mbikëqyrjes qytetare. Në vitin 2017, Shqipëria publikoi për herë të parë Planin e Përgjithshëm Hapësinor Kombëtar dhe Bashkitë zhvilluan Planet e Përgjithshme Lokale. Fokusi kryesor i qeverisjes në nivel lokal dhe rajonal ka rritur në mënyrë të theksuar kërkesën për informacione statistikore të besueshme dhe të përditësuara në nivele lokal dhe rajonal mbi fushat e popullsisë, ekonomisë, strehimit dhe mjedisit.

Censi i ardhshëm i Popullsisë dhe Banesave, do të luajë një rol vendimtar në përditësimin e informacionit statistikor të nevojshëm në nivel lokal dhe rajonal, si dhe në kuptimin dhe paraqitjen e ndryshimeve që kanë ndodhur në Shqipëri që nga viti 2001 dhe 2011. Censi do të kontribuojë gjithashtu në krijimin e një regjistri të ndërtesave dhe banesave dhe të regjistrave të popullsisë në nivel lokal dhe kombëtar, i cili do të jetë burimi i statistikave vjetore të censit në të ardhmen.

Censi konsiderohet si një projekt prioritar kombëtar nga qeveria shqiptare. Është thelbësor për hartimin e politikave të bazuara në evidenca dhe përcaktimin e synimeve sociale dhe - ekonomike, dhe planeve për zhvillim të qëndrueshëm në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, si edhe për një sistem statistikor të qëndrueshëm dhe efikas, bazuar në një kombinim të të dhënave

administrative dhe të anketave. Qëllimi është që Censi i Popullsisë dhe Banesave do të jetë censi i i fundit i kryer në mënyrë tradicionale.

1.3 Sistemi i statistikave shqiptare dhe roli i INSTAT

Ligji 8669, datë 26.10.2000 (i ndryshuar) mbi Censin e Përgjithshëm të Popullsisë dhe Banesave dhe Ligji Nr. 17/2017 "Për Statistikat Zyrtare" së bashku, identifikojnë INSTAT-in si autoritetin përgjegjës për kryerjen e Censit. Që nga fundi i viteve 1990, INSTAT ka fituar përvojë të gjerë në kryerjen e Censeve (Censi i Ndërmarrjeve Ekonomike 2010, Censet Bujqësore 1998 dhe 2012, Censet e Popullsisë dhe Banesave 2001 dhe 2011) dhe shumë anketime me zgjedhje, bazuar në metodologjitë e Kombeve të Bashkuara, Bankës Botërore dhe Eurostat. INSTAT ka krijuar gjithashtu Regjistrin e Ndërmarrjeve dhe po përdor gjithnjë e më shumë të dhëna administrative dhe të regjistrave për qëllime statistikore.

Për të forcuar rolin koordinues dhe pavarësinë e INSTAT në administratën shqiptare dhe për të sjellë kuadrin ligjor plotësisht në përputhje me standardet e BE-së dhe Kodin e Praktikës së Statistikave Europiane, parlamenti shqiptar në fillim të vitit 2018 miratoi një ligj tërësisht të rishikuar mbi Statistikat Zyrtare. Censi i Popullsisë dhe Banesave do të zhvillohet bazuar në ligjin e ri "Për statistikat zyrtare", 17/2018. Rishikimet e nevojshme të Ligjit për Censin e Popullsisë dhe Banesave do të jenë në përputhje me kontekstin e ri ligjor dhe për të forcuar rolin e INSTAT-it.

1.4 Rëndësia e mbështetjes nga donatorët

Megjithatë, mjedisi i ndryshuar ligjor dhe politik, nuk është i mjaftueshëm për të arritur progresin e pritshëm në Statistikat Zyrtare Shqiptare. Kompleksiteti i çështjeve në fjalë, madhësia e plotë e Censit të Popullsisë dhe Banesave dhe rëndësia e qëndrueshmërisë, kërkojnë investime në kohë për personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën. INSTAT ka personel të kualifikuar të kufizuar dhe për këtë arsye vazhdon të ketë nevojë për asistencë teknike dhe burime njerëzore dhe financiare shtesë. Është thelbësore të garantohet se INSTAT mund të përmbush misionin e tij dhe të arrijë një zhvillim të mtejshëm të sistemit statistikor kombëtar të Shqipërisë.

Përgatitja dhe zhvillimi i Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020, por i shtyrë në 2021 kërkon respektimin e afateve strikte, në këtë mënyrë edhe nevojën për ndërhyrje në kohë për financim. Kjo vlen për financimin nga qeveria shqiptare, si dhe për kontributet e donatorëve të cilat duhet të pasqyrojnë edhe shumëllojshmërinë e procedurave administrative kombëtare. Bazuar në strategjinë aktuale dhe dokumentin e planifikimit, INSTAT do të intensifikojë diskutimin me donatorët dhe do të vazhdojë takimet periodike me Grupin Koordinues të Donatorëve për të informuar mbi ecurinë e planit të punës dhe për të siguruar që fondet do të ndjekin kërkesat dhe afatet përkatëse. Përveç përkushtimit të qeverisë shqiptare, angazhime për të mbështetur linja dhe aktivitetet të caktuara të censit, së fundmijani të njohura nga donatorët e tjerë.

2. Objektivat e Censit të Popullsisë dhe Banesave

2.1 Kërkesat dhe rekomandimet ndërkombëtare

Censi i Popullsisë dhe Banesave do të ndjekë "Rekomandimet për Censin e Popullsisë dhe Banesave 2020 të Konferencës së Statisticienëve Evropianë"¹ (të cilat janë hartuar në bashkëpunim të ngushtë me Eurostat dhe në përputhje me rishikimin e "Parimeve dhe Rekomandimeve për Censet e Popullsisë dhe Banesave" globale: raundi i vitit 2020"².

Censi shqiptar do të ofrojë informacion për të gjitha temat kryesore të rekomandimeve të Konferencës së Statisticienëve Evropianë (CES) (Shtojca I e rekomandimeve): banorët e zakonshëm rezident të Shqipërisë dhe karakteristikat e tyre gjeografike, demografike, ekonomike, arsimore, migratore, Njësitë ekonomike familjare dhe karakteristikat e banesave. Konsultimet dhe -workshopte e planifikuara të INSTAT-it me përdoruesit e të dhënave do të tregojnë nëse temat e tjera jo të rëndësishme (si aftësia e kufizuar, karakteristikat etnokulturore ose bujqësia) duhet, gjithashtu të adresohen në Cens, ose nëse ato, duhet të mbulohen më mirë nga vrojtime ose burime të dhënash të tjera.

Rregulloret e Bashkimit Evropian ndërtohen gjithashtu mbi rekomandimet e CES. Rregullorja kuadër nr. 763/2008 mbi Censin e popullsisë dhe banesave të Këshillit dhe Parlamentit Evropian, kërkon që Shtetet Anëtare të ndjekin një program specifik për të dhënat statistikore dhe metadatave që i transmetohen Komisionit për një vit referimi të përbashkët të censit. Tre rregulloret e zbatimit të Komisionit të vitit 2017 përcaktojnë në detaje variablat, ndarjen numerike të të dhënave, analizën sasiore të të dhënave (cross-tab), metadatat, modalitetet e transmetimit dhe raportet e cilësisë të cilat duhet të ndiqen. Viti 2021 përcaktohet nga Komisioni si viti i ardhshëm i përbashkët i referencës për të dhënat që do të transmetohen në Eurostat³.

Rregulloret e BE-së janë ekskluzivisht të orientuar drejt produktit dhe nuk përshkruajnë një metodologji specifike për grumbullimin e të dhënave për statistikat e cens. Vendet mund të dorëzojnë të dhënat e cens bazuar në burime të ndryshme të të dhënave: censet konvencionale, regjistrat, sondazhet me zgjedhje/ ose kampjoneve qarkulluese (rotating samples) ose kombinime të ndryshme.

¹ Konferenca e Statistikanëve Europiane, Rekomandimet për Censin e Popullsisë dhe Banesave Kombet e Bashkuara, Nju Jork dhe Gjenevë, 2015

² Parimet dhe Rekomandimet për Censin e Popullsisë dhe Banesave: Raundi i vitit 2020 - Revizioni 3, Kombet e Bashkuara, Nju Jork 2015

³ Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2017/543 e datës 22 mars 2017 në lidhje me specifikimet teknike të temave të censit të popullsisë dhe banesave dhe të ndarjes së tyre; Rregullorja e Komisionit (BE) 2017/712 e datës 20 prill 2017 që përcakton vitin referues dhe programin e të dhënave statistikore dhe metada; Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2017/881 e datës 23 maj 2017 lidhur me modalitetet dhe strukturën e raporteve të cilësisë dhe formatin teknik për transmetimin e të dhënave.

Rregulloret e BE-së nuk janë të detyrueshme për vendet candidate të BE-së. Sidoqoftë, Censi i Shqipërisë *do të jetë plotësisht në përputhje me kërkesat e BE-së* rreth temave, koncepteve, përkufizimeve dhe ndarjeve hapësinore (duke përfshirë të dhënat gjeografike të grid). Kjo do të pasqyrohet në Ligjin për Censin e Popullsisë dhe Banesave dhe me vendimet e Këshillit të Ministrave (shih më poshtë, kapitullin 3.4).

2.2 Ndryshimet në metodologjinë e Censit

Që nga raundi i vitit 2000 i censeve ndërkombëtare, metodologjia e censit të popullsisë ka ndryshuar në mënyrë thelbësore në shumë vende evropiane. Shumë vende u larguan nga mbledhja tradicionale e informacionit nga anketuesit në të gjithë vendin, duke përdorur ose metodat e grumbullimit tërësisht të regjistruara, ose metodat e kombinuara të mbledhjes së të dhënave, duke përfshirë anketat me zgjedhje, për të zvogëluar koston dhe barrën e publikut, duke prodhuar në të njëjtën kohë informacion statistikor më të shpeshtë dhe më të përditësuar. Gjithësesi, për të arritur ndryshim në metodologji, disa kushte duhet të përmbushen dhe zbatohen, në marrëveshje me hartuesit e politikave,⁴ dhe palët e tjera interesuara të Censit.

Në vitin 2011, Shqipëria shprehu synimin për të ndryshuar metodologjinë për Censin e ardhshëm, por investimet e nevojshme, veçanërisht krijimi i regjistrave të besueshëm mbi ndërtesat dhe banesat, si dhe popullsinë e zakonshme rezidente nuk u zbatuan. Sot, kushtet për ndryshim janë shumë më të favorshme se dhjetë vjet më parë. Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm drejt digjitalizimit të administratës, e-qeverisjes dhe ndërveprimit elektronik me qytetarët. Qytetarët kanë numra unik të identifikimit, të cilat përdoren në të gjithë administratën. Një sistem regjistrimi për të gjitha bizneset është zhvilluar për tatime dhe për qëllime të tjera administrative. INSTAT po menaxhon Regjistrin e Ndërmarrjeve për qëllime statistikore. Sistemet GIS u zbatuan në administrata të ndryshme dhe u krijua një Agjenci për Koordinimin e GIS-it të Instaluar (ASIG), ku përfaqësohet edhe INSTAT. Sot, sistemet e komunikimit mobile mbulojnë të gjithë vendin dhe krijojnë kushtet për grumbullimin e të dhënave nëpërmjet kompjuterave të lëvizshëm etj.

Censi do të vazhdojë të zhvillohet si numërim në terren, por do të mbështetet në ecurinë e e-qeverisjes, do të përfshijë inovacione teknologjike dhe do të mbushë boshllëqet ekzistuese në rrugën drejt një censi të bazuar në regjistër. Përgatitjet për vitin 2021 do të kontribuojnë në krijimin e një regjistri statistikor të popullsisë rezidente, të ndërtesave dhe banesave dhe do të prezantojë mundësinë për të lidhur informacionin e censit me informacionin nga burimet administrative (për shembull Regjistri i Gjendjes Civile) për qëllime statistikore. INSTAT synon të prodhojë përditësime vjetore të informacioneve të rëndësishme të Censit pas pas rezultateve të Censit bazuar në një kombinim të burimeve të ndryshme të të dhënave, duke përfshirë edhe regjistrat.

Këto përpjekje janë në përputhje me "Strategjia për post-Censin 2021" të Eurostat-it dhe gjithashtu do të mbështetet nga projekti "Statistikat e Forta Lokale"(SALSTAT), financuar nga

⁴ Kapitulli I mbi Metodologjinë e Censit në Rekomandimet e CES (faqe 4-31) diskuton qasjet e ndryshme metodologjike për censet në Evropë, duke përfshirë kushtet e domosdoshme, avantazhet dhe disavantazhet.

Bashkëpunimi Zviceran për Zhvillim dhe i zbatuar nga INSTAT dhe Zyra Federale e Statistikave Zvicerane (FSO) në vitet 2018-2022.

2.3 Mësimet e nxjerra nga censi i popullsise dhe banesave 2011

Nga Censit i Popullsisë dhe Banesave 2011, mund të nxirren mësimet të rëndësishme operacionale si nga përvojat pozitive dhe negative. Disa mësimet kryesore përfshijnë si më poshtë:

- Krijimi i një Sistemi Informativ Gjeografik në Pronësi të INSTAT për të gjitha Bashkitë, Komunat dhe Zonat e Numërimit ishte një sukses i madh dhe ka mbështetur në mënyrë efikase përgatitjen e punës në terren, kryerjen e regjistrimit dhe shpërndarjen e të dhënave të përmirësuara. Në përgatitje për Censin, do të bëhen investime shtesë për të përditësuar teknologjinë GIS, zonat e regjistrimit, kufijtë e njësive hapësinore, adresat dhe identifikuesit e ndërtesave/ banesave në bashkëpunim me administratat e tjera. Ky investim do të shërbejë jo vetëm për censin, por përditësimin e planit të vërtetimit dhe kryerjen e anketave të ardhshme nga INSTAT dhe gjithashtu do të krijojë kushte për lidhjen e të dhënave hapësinore nga burime të ndryshme të të dhënave administrative për qëllime statistikore.
- Gjatë punës në terren, niveli i braktisjes së punës nga ana e kontrollorëve dhe anketuesve përbën një problem serioz. Një proces më i mirë për rekrutimin, trajnimin dhe përzgjedhjen e stafit të terrenit, përfshirë edhe anketuesit dhe kontrollorët reserve, është i nevojshëm. Paketat multimedia trajnimet mbi njohuritë kompjuterike dhe kurset për instruksionet do të implementohen dhe integrohen në tablet me procesin e grumbullimit të të dhënave.
- Kapja e të dhënave nga Lexuesi Optik i Karaktereve (OCR) kërkonte kohë, edhe pse ka qenë më efektiv se sa hedhja manuale e të dhënave. Në metodat inovative të mbledhjes së të dhënave të Censit nëpërmjet Intervistuesit Personal me Ndihmën e Kompjuterit (CAPI) do të zhvillohet dhe implementohet për të zvogëluar kohën për mbledhjen e të dhënave dhe për të përmirësuar cilësinë e të dhënave.
- Mungesa e të dhënave të mjaftueshme krahasuese nga burimet e të dhënave administrative për të kontrolluar cilësinë e të dhënave ka ngadalësuar përpunimin dhe redaktimin e të dhënave. Në Census është planifikuar një bashkëpunim më i ngushtë me zotëruesit e të dhënave administrative dhe të regjistrimit, për të përmirësuar planifikimin e punës në terren dhe kontrollin e cilësisë së të dhënave.
- Planifikimi dhe buxhetimi i aktiviteteve të censit nuk është kryer gjithmonë me kujdes dhe kjo ka sjellë ndikime negative në kalendarin e aktiviteteve. Për Censin është parashikuar të planifikohet me kujdes puna që do të kryhet në vijim, duke përcaktuar proceset, inputet dhe rezultatet si dhe të identifikojmë disponueshmërinë dhe nevojat për burime njerëzore dhe burime të tjera. Gjithashtu, do të jetë e rëndësishme të identifikohen rreziqet operacionale dhe të zhvillohen strategjitë dhe veprimet për parandalimin dhe zbutjen e rrezikut.
- Gjatë Censit të vitit 2011 janë bërë investime të rëndësishme në vizualizimin e të dhënave (duke përfshirë të dhënat e rrjetit të qelizave, përdorimin e hartave në internet si

dhe me mjete, atlaseve dhe mjeteve të tjera të vizualizimit. Kjo do të vazhdojë me përdorimin e mjeteve të reja interaktive Përveç kësaj, një fokus shumë më i madh do të vihet në shpërndarjen e të dhënave për Bashkitë dhe njësitë e vogla, duke përfshirë njësitë administrative në nivel bashkie dhe zbatimin e një politike të qasjes në mikrodata për qëllime kerkimore dhe planifikimi.

2.4 Mësimet e nxjerra nga Piloti i Censit të Popullësisë dhe Banesave 2019

Gjatë periudhës Tetor - Nëntor 2019 INSTAT organizoi Pilotin e Censit. Mësimet kryesore të mësuara gjatë këtij Piloti përfshijnë sa vijon:

- Nevoja për një njësi të dedikuar të caktuar për menaxhimin e përgjithshëm të sigurimit të cilësisë, përfshirë menaxhimin e rrezikut.
- Tërmeti i nëntorit 2019 dhe kriza aktuale COVID-19 nxori në pah nevojën për t'u përshtatur me faktorët e jashtëm dhe për t'i kthyer sfidat në mundësi. Përzgjedhja e platformës CAPI do të bazohet në konformitetin e platformave me kërkesat teknike, ekspertizën e brendshme, trajnimet dhe asistencën teknike në dispozicion.
- Një sistem më i hapur do të përdoret për zhvillimin e platformës CAPI në mënyrë që t'i lejojë përdoruesit zbatimin e zgjidhjeve ad-hoc.
- Platforma për zhvillimin e instrumenteve të Censit CAPI do të sigurojë fleksibilitet në drejtim të menaxhimit të integritetit të GIS, në leximin / shkrimin e të dhënave në nivel lokal dhe në server, si dhe në zhvillimin e një zgjidhjeje efektive për çështjet e hasura gjatë Pilotit të Censit.
- Strategjia e trajnimit të stafit të punës në terren do të miratohet për të siguruar që komunikime të sakta dhe të vazhdueshme të transmetohen në të gjitha nivelet e stafit në hierarkinë e Censit.
- Instrumenti për anketën e pas numërimit do të pilotohet paralelisht me Pilotin e Censit.
- Do të zhvillohet një fushatë e dedikuar komunikimi për Pilotin e Censit.
- Koordinimi dhe integrimi i komunikimeve të Censit dhe aktiviteteve të rekrutimit të stafit të punës në terren.

2.5 Objektivat strategjike të Censit të Popullësisë dhe Banesave

Bazuar në sa më sipër, INSTAT përcakton objektivat e mëposhtme strategjike për Censin e Popullësisë dhe Banesave:

- Censi do të krijojë informacionin bazë statistikor mbi popullsinë, ndërtesat dhe banesat për të gjithë territorin e Shqipërisë, i cili është thelbësor për ndërtimin e institucioneve, zhvillimin e qëndrueshëm, demokracinë dhe qeverisjen e mirë në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.
- Ndarjet hapësinore të Censit do të bëhen të krahasueshme me ato të vitit 2011 dhe 2001 dhe do të nxjerrin në pah ndryshimet demografike, ekonomike dhe shoqërore gjatë dy dekadave të fundit për njësitë e vjetra dhe të reja territoriale dhe administrative. Të dhënat do të shërbejnë gjithashtu për krahasimet ndërkombëtare duke ndjekur kërkesat e

rregulloreve të BE-së dhe shpërndarjen e të dhënave nëpërmjet qendrës së Censusit të BE-së.

- Të dhënat do të bëhen të disponueshme në formë të agreguar dhe si mikrodata duke filluar nga zonat më të vogla gjeografike në nivelin bashkie deri në atë kombëtar dhe nëpërmjet një rrjetit të qelizave 1 km²grid për të lehtësuar zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e planeve dhe programeve të zhvillimit, si dhe për politika të tjera dhe qëllime kërkimore shkencore. Kujdes i madh do të ushtrohet për të mbrojtur konfidencialitetin dhe për të parandaluar zbulimin pa dashje të informacionit të Censit rreth individëve të identifikueshëm dhe njësive të tjera statistikore.
- INSTAT do të përdorë teknologjinë moderne të TI-së për të përgatitur dhe kryer regjistrimin në terren në një mënyrë të besueshme, efikase dhe me kosto efektive. Investimet në hardware, software dhe ngritje të kapaciteteve do të përpiqen të forcojnë mjedisin e përgjithshëm të TI-së të INSTAT-it dhe të gjejnë zgjidhje të cilat janë të qëndrueshme dhe të ripërdorshme për vrojtime dhe aktivitete të tjera statistikore.
- Censi do të përdorë burimet të disponueshme administrative për përgatitjen e Censit, si dhe për kontrollin e cilësisë. INSTAT-i gjithashtu do të punojë me administratat e tjera gjatë Censit për të krijuar kushte për krijimin e një regjistri ndërtesash dhe banesash dhe një regjistri të popullsisë rezidente që mund të shërbejë si burim për statistikën e Censit bazuar në regjistra. Bazuar në Cens, INSTAT gjithashtu do të zhvillojë një kornizë të re për marrjen e kampioneve për të ri-formatuar dhe për të forcuar vërtetimet me zgjedhje në Shqipëri. Kjo do të përmirësojë infrastrukturën bazë të të gjithë sistemit statistikor.
- Për përfshirjen e popullatës shqiptare, informimin dhe rekrutimin e anketuesve, kontrollorëve dhe mbikëqyrësve dhe përgatitjen e bashkive dhe administratave qeveritare për censin, INSTAT do të iniciojë konsultime dhe do të zhvillojë një fushatë të gjerë komunikimi për pjesëmarrjen e qytetarëve, metodologjinë, përmbajtjen dhe të dhënat e pritshme të censit të vitit 2021.
- Në përcaktimin e çështjeve të Censit, konceptet dhe përkufizimet përkatëse si dhe programet statistikore dhe metadatave, INSTAT do të ndjekë rekomandimet e Kombeve të Bashkuara, rregulloren kuadër të Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe rregulloret e zbatimit të Komisionit Evropian.
- Është planifikuar shtyrja e datës së Censusit me një vit në 1 Tetor 2020, krahasuar me ritmin 10 vjeçar të ndjekur për dy Censet e mëparshme (2001 dhe 2011). Arsye të operacionale. Në verën e vitit 2021, zgjedhjet kombëtare do të mbahen në Shqipëri.
- Fushata zgjedhore do të përputhej me përgatitjet për Censin në 2021 (përfshirë fillimin e fushatës së komunikimit dhe publicitare të Censit). Duke marrë parasysh sigurinë e popullsisë shqiptare dhe personelit të Censit nën pandeminë globale COVID-19 dhe zgjedhjet kombëtare, INSTAT ka shtyrë punën në terren për në Tetor 2022. INSTAT

konsideron çështjet e përmendura më lart si rreziqe serioze për zhvillimin e suksesshëm të Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave Shqiptare.

3. Legjislacioni i Censit

3.1 Ligji i Censit

Në mënyrë që Censi të kryhet në përputhje me strategjinë aktuale, është e nevojshme të rishikohet Ligji aktual i Censit (Nr.8669, datë 20.10.2000, i ndryshuar). Rishikimi do të synojë sa më poshtë:

- Përputhjen me terminologjinë dhe përkufizimet etj. të legjislacionin të BE-së për Censet;
- Harmonizimin me Ligjin e ri Nr. 17/2017 "Për Statistikat Zyrtare";
- Adoptimin e neneve mbi organizimin dhe rolin e Komisionit Qendror të Censit pas përforcimit të rolit operacional dhe metodologjik të INSTAT siç është përshkruar në ligjin e ri "Për Statistikat Zyrtare";
- Adoptimin e neneve mbi organizimin dhe rolin e Komisioneve Bashkiakë në strukturën e propozuar të Censit pas reformës territorial dhe administrative.
- Mbështetjen e strategjisë së regjistrimit të INSTAT dhe lidhjen e ardhshme të të dhënave administrative nëpërmjet adresave unike dhe / ose ID-ve për qëllime statistikore;
- Të sigurojë koherencë ndërmjet neneve të ligjit.

3.2 Kalendar i punës për legjislacionin

Projektligji është shqyrtuar nga gjashtë komisione parlamentare, përpara se të miratohet nga Parlamenti Shqiptar.

Vendimi për Komisionin Qendror të Censit do të fillojë menjëherë pas miratimit të Ligjit. Miratimi i Parlamentit në lidhje me datën e saktë, periudhën e numërimit dhe pyetësorët do të merren pasi të miratohet plani vjetor për 2022 dhe Programi Statistikor Zyrtar.

3.3 Përafrimi me legjislacionin e BE-së

Në paraqitjen e projektligjit të ri për Censin e Popullsisë dhe Banesave, INSTAT-i duhet të sigurojë një tabelë pajtueshmërie që tregon nivelin e përputhshmërisë me legjislacionin përkatës të BE.

Qeveria e Shqipërisë nuk ka ndonjë kërkesë ligjore për të miratuar rregulloret e BE-së, por gjatë paraqitjes së projekt propozimeve për ndryshime në Ligjin e Censit në Parlament, duhet të sigurohet nga INSTAT një tabelë e përputhshmërisë që tregon nivelin e pajtueshmërisë me çdo legjislacion të rëndësishëm të BE-së.

Për të qenë plotësisht në përputhje me legjislacionin e BE-së (shih kapitullin 2.1), Shqipëria do të sigurojë që Ligji i Censit dhe vendimet pasuese të Këshillit të Ministrave të jenë në përputhje me përkufizimet, çështjet, klasifikimet, ndarjet gjeografike dhe rezultatet statistikore të kërkuara nga rregullorja kuadër e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, si dhe nga rregulloret e zbatimit të Komisionit Evropian. Çështjet e kërkuara janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela 1: Çështjet mbi të cilat janë kërkuar të dhënat sipas rregullores së zbatimit të KE-së Nr 2017/543

Çështjet që i referohen personave:

- Vendbanimi i zakonshëm
- Vendndodhja e vendit të punës
- (Përmasa) e lokalitetit
- Gjinia
- Mosha
- Statusi martesor ligjor
- Statusi i veprimtarisë aktuale
- Profesioni
- Industria
- Statusi në punësim
- Niveli arsimor i arritur
- Shteti / vendlindja
- Shtetësia
- Keni jetuar ndonjëherë jashtë shteteit dhe viti i kthimit
- Vendi i mëparshëm i vendbanimit të zakonshëm një vit para cens
- Statusi I njësisë ekonomike familjare
- Statusi brenda familjes (brenda njësisë ekonomike familjare)

Çështjet që i referohen bërthamave familjare:

- Lloji i bërthamës familjare
- Madhësia e bërthamës familjare

Çështjet që i referohen njësisë ekonomike familjare private:

- Tipi i njësisë ekonomike familjare
- Madhësia e njësisë ekonomike familjare
- Statusi i pronësisë

Çështjet që i referohen banesave:

- Tipi i banesës
- Statusi i banimit
- Numri i banorëve
- Hapësira e shfrytëzueshme e katit dhe / ose numri i dhomave
- Standarti i dendësisë
- Sistemi i furnizimit me ujë
- Objektet e tualetit
- Dush/vaskë në banesë
- Lloji i ngrohjes
- Lloji i pronësisë

Çështjet që i referohen ndërtesave ku ndodhet banesa:

- Tipi i ndërtesës
- Periudha e ndërtimit

Rregullorja kuadër e BE-së e vitit 2008 parashikon se Censet duhet të zhvillohen në fillim të një dekade dhe përfshirë si referencë Censin e BE-së në vitin 2011. Viti i referencës për censin e ardhshëm të BE-së është përcaktuar në rregulloren e zbatimit 2017/712 të KE-së. Shtetet Anëtare u kërkohet të paraqesin të dhëna diku në vitin e referencës 2021, por nuk ka një datë të përbashkët referimi. Neni 3 parashikon: "Çdo shtet anëtar do të përcaktojë një datë referimi që përkon në vitin 2021 për të dhënat e Censit të Popullsisë dhe Banesave që do tëi transmetohen Komisionit (Eurostat). Shtetet Anëtare do të informojnë Komisionin (Eurostat) deri më 31 dhjetor 2019 për datën e përzgjedhur të referencës.

4. Komunikimi dhe fushata publicitare

4.1 Objektivat

Suksesi i Censit varet në një masë të madhe nga angazhimi pozitiv dhe pjesëmarrja e popullsisë shqiptare në këtë proces. Për këtë arsye, është thelbësore që të zhvillohet një fushatë efektive komunikimi dhe ndërgjegjësimi, të mbështetur nga qeveria dhe të zbatuar me mjetet moderne të medias dhe të informimit publik. Nenet 13 dhe 16 të Ligjit aktual të Censit ngarkojnë INSTAT-in të zhvillojë një fushatë të tillë "para ditës së Censit ... dhe deri në nxjerrjen e rezultateve përfundimtare".

Qëllimi i fushatës është të promovojë Censin e Popullsisë dhe Banesave, të informojë për qëllimin dhe rezultatet e Censit dhe të ndihmojë në forcimin e besimit në vetë procesin e Censit dhe në institucionet përgjegjëse.

Objektivat e fushatës janë:

- Të fitojë mbështetjen publike të aktorëve të ndryshëm dhe liderëve politikë me ndikim në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor;
- Të informojë popullatën sa më saktë mbi atë se çfarë është Censi i Popullsisë dhe Banesave dhe mbi rëndësinë e pë bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes në Cens.
- Të informojë dhe sensibilizojë qytetarët për procesin e grumbullimit elektronik të të dhënave, rolin e anketuesve dhe përse është e lehtë dhe e sigurt pjesëmarrja;
- Të informojë dhe sigurojë qytetarët për privatësinë dhe konfidencialitetin e procesit, si dhe mbrojtjen e të të dhënave në vazhdimësi;
- Të eliminojë konceptet e gabuara dhe të kundërshtojë informacionin e rremë duke siguruar një mbulim të duhur dhe të drejtë mediatik;
- Nxitja e besimit të publikut në INSTAT si një Institut Kombëtar Statistikor teknikisht i aftë i cili mbështetet nga Bashkimi Evropian dhe nga donatorë të tjerë ndërkombëtarë;
- Të informojë publikun rreth rezultateve kryesore të censit, si dhe shpërndarjen e informacionit të mbledhur në komunitet dhe palët e interesit në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.

4.2 Grupet e synuara

Për të siguruar që fushata e komunikimit dhe ndërgjegjësimit të arrijë tek të gjithë qytetarët, palët e interesuara dhe ndërmjetësit që mund të luajnë një rol në veprimtarinë e Censit, ajo do të hartohet për të arritur grupe të ndryshme të synuara, veçanërisht:

- Hartuesit e politikave dhe vendimmarrësit;
- Ministritë dhe agjencitë në nivel kombëtar;
- Përfaqësuesit e Pushtetit Vendor;
- Administratat rajonale dhe bashkiake;
- Aktorët kryesorë të sektorit të arsimit;
- Shoqërinë civile dhe OJQ-të, duke përfshirë shoqatat e grave, shoqatat e të rinjve etj;
- Kandidatët e mundshëm për rolin e anketuesit dhe kontrolluesit;
- Përfaqësuesit e medias;

Për të zhvilluar një partneritet me mediat do të ndihmonte përfshirja e tyre në bord për veprimtarinë e Censit, si edhe për të zbuluar çështje të hershme që mund të pengojnë pjesëmarrjen e popullsisë (për shembull problemet mbi ruajtjen e konfidencialitetit).

4.3 Mjetet e komunikimit

Fushata publicitare do të arrijë tek publiku dhe te palët e interesuara specifike, duke përdorur një shumëllojshmëri të mediave, kanaleve të komunikimit dhe teknikave. Për t'i ardhur në ndihmë procesit do të përdoren kanalet dhe mjetet e mëposhtme të komunikimit:

- Publiciteti përmes tryezave të rumbullakëta, mediave të shkruara, njoftime dhe reklama në radio dhe televizione, faqeve të reklamave, instalimeve në faqe interneti etj;
- Konferenca, njoftime për shtyp, intervista, reklama dokumentare, transmetime radio dhe televizive;
- Reklama vizuale: banderola, postera, etj;
- Reklama direkte: letra, fletëpalosje, takime, seminare, telefonata;
- Shpërndarja e mesazheve nëpërmjet rrjeteve sociale, etj.

Një listë e mediave dhe programeve të përzgjedhura ku do të transmetohet fushata publicitare, do të zhvillohet në një plan publiciteti, bazuar në rëndësinë e mediave (në aspektin e mbulimit gjeografik, vlerësimit të audiencës dhe cilësisë së programimit) dhe nevojës për transmetimin dhe shpërndarjen e komunikimeve në kohë të ndryshme si dhe me përmbajtje të ndryshme dhe audienca të synuara.

4.4 Kohëzgjatja dhe modulimi

Komunikimi rreth Censit do të fillojë gjatë fazës së përgatitjes përmes identifikimit të aktorëve kryesorë kontaktit me pushtetin qendror dhe lokal, parlamentit, shoqërisë civile etj., dhe një fushatë më e fokusuar do të fillojë përparanumërimin actual.. Fushata e madhe publicitare do të

zgjasë tre muaj dhe gradualisht do të bëhet më intensive. Modeste në fillim, do të bëhet gjithnjë e më intensive me afrimin e ditës së Censit dhe do të arrijë kulmin e saj gjatë muajit që paraprin numërimin dhe gjatë periudhës së numërimit, deri në përfundimin e Anketës së Pas-Regjistrimit.

Plani i komunikimit do të përcaktojë aspektet e ndryshme në lidhje me zbatimin e fushatës dhe do të përcaktojë një plan aktivitete: planifikimin dhe kohëzgjatjen e fushatës, orarin dhe frekuencën e transmetimeve në radio dhe televizion si dhe publikimin e materialeve në gazeta, përmbajtjen e komunikimeve, ndërhyrjet e një firme të specializuar dhe të aktorëve të ndryshëm etj.

4.5 Mbështetja e jashtme

Një kompani e specializuar në trajnimet mbi komunikimin, e cila do të punojë së bashku me INSTAT, do të kontraktohet për fushatën e komunikimit dhe publicitetit.

Do të rekrutohen dizenjues të cilët do të përgatisin përmbajtjen vizuale për Censin si fletëpalosje, postera dhe grafikë informacioni që do të përdoren në evente, takime dhe media sociale.

Gjithashtu, do të rekrutohen ekspertë të përfshirë në mediat sociale dhe monitorimin e medias, si dhe ekspertë lokalë me kohë të pjesshme me ekspertizën e kërkuar në fushën e komunikimit për të përgatitur zëdhënës dhe advokim të medias.

Përveç kompanisë së specializuar, do të jetë e rëndësishme edhe përfshirja e aktorëve të tjerë dhe grupeve të interesit për të luajtur rolin e tyre në fushatë, për të maksimizuar impaktin e saj në popullatë, siç janë ministrinë, agjencitë, shoqëria civile dhe komisionet bashkiake.. Gjithsesi, ndërhyrjet e tyre do të jenë në përputhje me kushtet e përcaktuara në planin e përgjithshëm të komunikimit dhe publicitetit.


5. Menaxhimi dhe organizimi i Censit

5.1 Organizimi i Censit

Censet e Popullsisë dhe Banesave janë veprimtaritë më të mëdha statistikore në çdo vend. Në një Cens, faza përgatitore përfshin krijimin e strukturës organizative, aktivitetet hartografike, listimin e ndërtesave dhe banesave dhe grumbullimin e tyre. Pas fazës së numërimit, bëhet përpunimi i të dhënave, i ndjekur nga shpërndarja e rezultateve dhe analizat e raportet e mëtejshme, duke përfshirë një vlerësim.

Bazuar në Ligjin e Censit, Censi i ardhshëm do të organizohet dhe kryhet nga Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT), nën mbikëqyrjen e Komisionit Qendror të Censit dhe me mbështetjen e Komisioneve të Cens në nivel Bashkie. Rolet dhe përgjegjësitë e tyre përcaktohen me Ligj dhe me Vendimet e Këshillit të Ministrave (shih kapitullin 3). Figura e mëposhtme tregon organizimin e planifikuar të Censit:

Figura 1: Organizimi i Censit



5.2 Njësia e Censit pranë INSTAT

Për të siguruar që INSTAT-i të marrë përgjegjësinë e zbatimit me sukses të Censit dhe menaxhojë buxhetin e tij, Censi do të organizohet si një projekt, i planifikuar me detaje dhe të zbatohet me efikasitet. Kjo kërkon një nivel të lartë të ekspertizës teknike dhe administrative. Ngritja e njësisë së dedikuar të Censit në INSTAT është po aq e rëndësishme sa aftësitë profesionale të stafit të përfshirë në zbatimin e tij.

Përvoja e Censit të vitit 2011 tregon se krijimi brenda INSTAT-it të një njësie profesionale për Censin është një kërkesë e domosdoshme. Për këtë qëllim, INSTAT do të rekrutojë staf të kualifikuar si në zyrat qendrore dhe në ato rajonale. Aktivitetet e mëposhtme në lidhje me menaxhimin e cens do të përfshihen gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit të censit:

- Përcaktimi dhe zbatimi i strukturës organizative dhe të menaxhimit të Censit;
- Organizimi dhe mobilizimi i fondeve dhe burimeve;
- Krijimi i një sistemi menaxhimi dhe raportimi për kontributet e donatorëve;
- Krijimi i protokolleve të raportimit të brendshëm dhe të jashtëm të projektit;
- Krijimi i kuadrit të monitorimit, sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit të projektit;

- Kryerja e menaxhimit të ri-shikimit të të gjitha aktiviteteve;
- Ngritja e kapaciteteve institucionale dhe të stafit të INSTAT-it.

5.3 Struktura organizative e INSTAT për Censin (Njësia e Censit)

Njësia e Censit drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it dhe përbëhet nga anëtarë pjesë e personelit të INSTAT-it dhe të punësuar të tjerë me kontratë pune vetëm për angazhimin në Cens.

Njësia e Censit do të përbëhet nga:

- a) *Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT*, drejtues i Njesisë së Cens, që ka përgjegjësinë e përgjithshme për Censin e ardhshëm, koordinimin me aktorët e jashtëm dhe me Parlamentin, Këshillin e Ministrave, Komisionin Qendror të Censit dhe Donatorët;
- b) *Njësia e Koordinimit të Censit* me përgjegjësinë e mbikëqyrjes së zbatimit të aktiviteteve të Censit sipas planit për zbatimin e tij, duke siguruar cilësinë e të gjitha proceseve dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara në këtë Strategji. Njësia e Koordinimit të Censit kryesohet nga drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të TI dhe Mbledhjes së të Dhënave dhe ka për anëtarë drejtorin e Drejtorisë së Statistikave Sociale dhe Sekretarin e Përgjithshëm të INSTAT-it.
- c)
- d) *Njësia IPA* e dedikuar për programimin, zbatimin, monitorimin dhe raportimin e projekteve të financuar nga BE brenda institucionit, e cilado të jetë përgjegjëse për monitorimin e zbatimit teknik të grantit.
- e) *Zyra mbështetëse e Projektit* e përbërë nga një ekspert për aspektet teknike, si dhe një ekspert për aspektet financiare dhe administrative, të cilët do të mbështesin Njësia IPA dhe Njësia e Koordinimit të Cens në lidhje me proceset teknike, financiare, administrative të zbatimit të aktiviteteve të Censit të cilat mbulohen nga projekti/granti.
- a) *Njësitë dhe ekipet teknike*, të cilët do të koordinohen dhe mbikëqyren nga Njësia e Koordinimit të Censit si më poshtë:
 - f)
 - Njësia Juridike përgjegjëse për formalizimin e normave nga ana juridike për të siguruar ecurinë e Censit në përputhje me legjislacionin për censin e popullsisë dhe banesave;
 - Njësia e Metodologjisë, Tabulimit dhe APC përgjegjëse për kuadrin metodologjik, tabelar dhe Anketën pas Cens (APC) me ekipet në varësi si më poshtë:
 1. Ekipi Teknik i Metodologjisë dhe Tabulimit
 2. Ekipi Teknik i APC
 - Njësia e TI dhe Cilësisë përgjegjëse për infrastrukturën teknologjike dhe cilësinë e proceseve gjatë zbatimit të Censit me ekipet në varësi si më poshtë:
 1. Ekipi Teknik i Teknologjisë së Informacionit
 2. Ekipi Teknik i Cilësisë

1. Njësia e GIS dhe Logjistikës përgjegjëse për aspektin gjeohapësinor dhe logjistikën e Censit si dhe organizimin e punës të stafit të Censit në terren, me ekipet në varësi si më poshtë: Ekipi Teknik për Gjeoinformacionin (GIS)
2. Ekipi i Organizimit dhe Logjistikës
- Njësia e Burimeve Njerëzore, Financës dhe Prokurimeve përgjegjëse për aspektin njerëzor, financiar dhe prokurimet lidhur me Censin me ekipet në varësi si më poshtë:
 1. Ekipi për Burimet Njerëzore
 2. Ekipi për Financën
 3. Ekipi për Prokurimet
- Njësia e Komunikimit dhe Shpërndarjes përgjegjëse për aspektin publicitar, aktivitetet promocionale dhe komunikimit të Censit me ekipet në varësi si më poshtë:
 1. Ekipi për Komunikimin
 2. Ekipi për Publikimin dhe Shpërndarjen

Sekretariati i Njesisë së Censit do të sigurohet nga Njësia e marrëdhënieve me organizmat mbështetëse, njësi e cila do të mbulojë edhe funksionet e sekretariatit të Komisionit Qendror të Censit.

5.4 Mjetet e menaxhimit dhe monitorimit të projektit

Projekti i Censit do të zhvillohet duke ndjekur metodën e menaxhimit të projektit. Do të përgatitet plani i përgjithshëm i aktiviteteve me tre nivele detajesh: fazat, aktivitetet, detyrat, njësia përgjegjëse dhe Indikatorët kryesorë të performancës (KPI). Rezultatet do të identifikohen qartë. Hapat e rëndësishëm të projektit do të identifikohen si aktivitete të rëndësishme (milestones).

Plani i punës dhe buxheti do të dokumentohen qartë dhe do të rishikohen dhe përditësohen rregullisht nga Njësia e Censit të INSTAT-it dhe Komiteti Drejtues. Dokumentacioni i projektit do të menaxhohet në një arkivë qendrore, duke përdorur sistem arkivimi që mundëson kontrollin/ri-shikimin. Raportet e rregullta të veprimtarisë do të prodhohen nga njësitë teknike dhe nga Drejtuesi i Ekipit për Komitetin Drejtues të Censit, Komisionin Qendror të Censit dhe Komitetin e Koordinimit dhe Raportimit të Donatorëve.

6. Metodologjia e censit 2020

6.1 Parimet metodologjike

"Censi i popullsisë" është operacioni që prodhon në intervale të rregullta numërimin zyrtar të popullsisë në gjithë territorin e vendit dhe në nën-territoret e saj më të vogla gjeografike së bashku me informacionin për një numër të caktuar të karakteristikave demografike dhe sociale të popullsisë së përgjithshme. Për të planifikuar dhe zbatuar politikën e zhvillimit ekonomik dhe social, aktivitetet administrative ose kërkimet shkencore, është e nevojshme të kemi të dhëna të besueshme dhe të detajuara mbi madhësinë, shpërndarjen dhe përbërjen e popullatës.

Ndërkohë që Censi është thelbësor për shpërndarjen e burimeve dhe planifikimin, duke qenë sekryhet vetëm çdo dhjetë vjet, për planifikimin në vitet e ndërmjetëm janë të nevojshme metoda të tjera. Vlerësimet e popullsisë prodhohen çdo vit për të lejuar planifikimin kombëtar dhe vendor dhe ka filluar puna për të krijuar kushtet për të lëvizur drejt censit të bazuar në regjistra duke rritur përdorimin e të dhënave administrative.

Metodologjia e Censit bazohet në Rekomandimet për Censin e Popullsisë dhe Banesave 2020 të miratuara nga Konferenca e Statisticientëve Europian dhe në përputhje me Rregulloren e BE-së 2017/543 të datës 22 mars 2017 që përcakton rregullat për zbatimin e Rregullores (KE) nr. 763/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi censet e popullsisë dhe banesave në lidhje me specifikimet teknike të çështjeve dhe ndarjeve të tyre.

Censi do të ndjekë parimet e përcaktuara në rekomandimet ndërkombëtare të përmendura më lart:

- Numërimin individual
- Njëkohshmërinë
- Universalitetin
- Të dhënat e zonave të vogla.
-

Për Censin, INSTAT do të përdorë numërimin tradicional derë më derë përmes intervistave me pyetësorët. Sidoqoftë, anketuesit nuk do të përdorin pyetësorët e printuar (si në Censet e vitit 2001 dhe 2011), por pyetësorët elektronikë në tableta (shih kapitullin 9 për mjedisin e TI-së dhe infrastrukturën e propozuar).

6.1.1 Përgatitja për censin bazuar në regjistra

Censi i ardhshëm do të ofrojë hapat bazë drejt një regjistri statistikor ndërtesash dhe banesash. Një regjistër i tillë do të vendos bazat për regjistrin statistikor të popullsisë dhe banesave në të ardhmen. Megjithatë, regjistri i popullsisë dhe banesave do të jetë pjesë e projektit SALSTAT për të krijuar elementët bazë duke përdorur infrastrukturën operacionale të censit dhe elementët e planifikuar për regjistrin e ndërtesave dhe banesave. Për këtë, referenca thelbësore janë sistemi i adresave dhe regjistri i popullsisë i ngritur nga Zyra e Gjendjes Civile. Cilësia e informacionit të tyre do të vlerësohet gjatë aktiviteteve pilot të censit.

Për më tepër, legjislacioni i censit duhet të përshtatet për të lejuar lidhjen e mundshme me regjistrat ekzistues për të shkuar drejt një regjistri të popullsisë dhe njësive ekonomike familjare. Mundësia e përdorimit të mëtejshëm dhe lidhja e mundshme e të dhënave të mbledhura të censit me të dhënat administrative për ndërtimin e regjistrave të tillë është një parakusht, suksesi i të cilit kërkon përkushtim dhe shumë përpjekje.

Ndonëse njihen përparësitë e një Censi bazuar në regjistra (kostot e reduktuara dhe më pak ngarkesë) ekzistojnë disa kushte për ndërtimin e tij, dhe mund të nevojitet kohë për të futur qasjen e regjistrit në më shumë hapa. Një tentativë për përdorimin e mënyrës së kombinuar duke përdorur përprocesin e mbledhjes së të dhënave në terren listat e adresave dhe regjistrat e gjendjes civile, do të testohet gjatë fazës së zbatimit të Censit. Ndërkohë, kushtet për zhvillimin e Censit të popullsisë bazuar në regjistra kërkojnë një strategji të pavarur për t'u zhvilluar.

Procesi i kalimit drejt një qasjeje të bazuar në regjistra merr kohë dhe mund të arrihet në disa hapa. Elementet e para të të dhënave që do të merren nga regjistrat mund të jenë adresat dhe elementët bazë të të dhënave demografike nga të dhënat e regjistrit civil. Pasi, procesi i marrjes së dhënave administrative rritet hap pas hapi, duke përfshirë të dhënat nga regjistrat e tjerë si: punësimi, arsimi, etj, atëherë është e rëndësishme të kemi një regjistër të popullsisë me cilësi të lartë dhe një sistem identifikimit numerik të përbashkët përpara çdo përpjekje për të lidhur të dhëna nga burime të ndryshme administrative. Duhet të ketë një sistem efektiv në përditësim të vazhdueshëm të regjistrave si edhe komunikim midis sistemeve të tyre.

Kushti tjetër që duhet përmbushur është se regjistrat themelorë që duhet të përdoren për një Cens të popullsisë, si regjistri i popullsisë dhe/ose regjistri i ndërtesave dhe banesave mund të sigurojnë mbulim të plotë dhe të gjitha njësitet statistikore duhet të lidhen me njëra-tjetrën me anë të sistemeve të identifikimit. Për shembull, duhet të ketë kapacitet për t'i lidhur personat me njësitet ekonomike familjare, banesat dhe ndërtesat në të cilat ata jetojnë. Gjithashtu, të lidhë personat e punësuar me punëdhënësit e tyre. Punëdhënësit dhe ndërtesat gjithashtu duhet të lidhen, në mënyrë që të përcaktohet vendodhja e punës. Në mënyrë të ngjashme, të gjitha njësitet duhet të përcaktohen gjeografikisht duke përdorur kodet e zonës lokale ose koordinatat e hartës. Një faktor kryesor që lehtëson përdorimin statistikor të të dhënave administrative është aplikimi i sistemeve të unifikuara të identifikimit nëpërmjet burimeve të ndryshme. Lidhja e të dhënave duhet të ndodhë në nivelin individual. Përkufizimet e elementeve të të dhënave në burimet administrative duhet të jenë të njëjta si në cens, ose ato duhet të jenë të konvertueshme për të përmbushur përkufizimet e cens. Gjithashtu, është thelbësore që të harmonizohen konceptet dhe përkufizimet midis regjistrave. Për të siguruar këtë, vlerësimet e cilësisë duhet të kryhen në mënyrë periodike.

Në fund, për të siguruar të gjithë procesin, legjislacioni kombëtar duhet të sigurojë bazën për përdorimin e burimeve të të dhënave administrative për qëllime statistikore. Ky legjislacion duhet t'i japë kompetenca INSTAT për të përdorur të dhënat administrative në nivel njësie statistikore me të dhënat identifikuese dhe për t'i lidhur ato për qëllime statistikore. Për më tepër, legjislacioni i duhur duhet të sigurojë nivele të mjaftueshme të mbrojtjes së të dhënave. Gjithashtu, është e rëndësishme që publiku i gjerë të kuptojë dhe vlerësojë përfitimet e përdorimit të regjistrave si burime për qëllime statistikore dhe se ka pranim të gjerë nga publiku, të përdorimit të këtyre të dhënave administrative për qëllime të prodhimit statistikor.

6.2 Modalitetet dhe mënyra e numërimit

6.2.1 Vendbanimi i zakonshëm

Popullsia do të numërohet në bazë të vendbanimit të tyre të zakonshëm, në një banesë individuale ose në banesa kolektive. 'Popullsia rezidente' është, sipas përcaktimit ndërkombëtar, e përbërë nga ata persona që kanë vendbanimin e tyre të zakonshëm në vend në kohën e referimit të cens dhe kanë jetuar ose kanë ndërmend të jetojnë atje për një periudhë të vazhdueshme prej së paku 12 muajsh. Një 'periudhë e vazhdueshme kohore' do të thotë se mungesat (nga vendi i vendbanimit të zakonshëm), kohëzgjatja e të cilave është më e shkurtër se 12 muaj nuk ndikojnë në vendbanimin e zakonshëm. Të njëjtat kritere zbatohen për çdo ndarje territoriale përkatëse (duke qenë vendi i banimit të zakonshëm) brenda vendit.

6.2.2 Popullata që do të regjistrohet

Të gjithë personat, me shtetësi shqiptare ose të huaj dhe personat pa shtetësi, por duke përjashtuar personelin diplomatik të huaj të akredituar në Shqipëri, të cilët në momentin e Censit janë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, janë të detyruar të japin informacionin e kërkuar nga pyetësi i Censit të Popullsisë dhe Banesave. Në këtë mënyrë, kjo do të përfshijë rezidentët e zakonshëm dhe jorezidentët të cilët janë përkohësisht të pranishëm në Shqipëri në momentin e Censit.

6.2.3 Data e referencës dhe kohëzgjatja e cens në terren

Data e referencës së Censit, e cila është gjithashtu data e fillimit të numërimit, do të jetë 1 tetor 2022, në orën 00:00. Mbledhja e të dhënave do të zgjasë gjashtë (6) javë. Megjithatë, mund të konsiderohet një periudhë prej dy (2) javësh shtesë, në rast të problemeve të papritura ose vështirësive për të hyrë në zonat më të largëta dhe/ose në një ose më shumë qarqe, dhe në rast të fatkeqësive natyrore, p.sh në rast përmbytjesh, stuhish etj.

6.2.4 Mënyra e mbledhjes së të dhënave

Metoda kryesore e përdorur për mbledhjen e të dhënave do të jetë intervista direkte. Prandaj, anketuesit e trajnuar më parë do të intervistojnë, për çdo njësi ekonomike familjare, anëtarët e rritur, ose të paktën një anëtar të rritur që mund të japë përgjigje për të gjithë anëtarët e familjes. Për banesat kolektive, ata do të numërojnë të gjithë banorët e zakonshëm, qoftë drejtpërdrejt ose nëpërmjet menaxhimit të institucionit.

6.2.5 Të anketuarit

I anketuari i përshtatshëm është çdo person i cili është të paktën 15 vjeç dhe që banon në njësinë ekonomike familjare dhe mund të japë përgjigje të sakta për pyetjet e bëra nga anketuesi. Përgjigjet do të kërkojnë të jenë individuale sa më shumë që të jetë e mundur nga çdo anëtar i pranishëm në familje në kohën e intervistës.

6.2.6 Modaliteti i intervistës

Intervista do të jetë e drejtpërdrejtë, që do të thotë se anketuesi, duke përdorur një tablet (pajisje elektronike që mbahet në dorë) që përmban aplikacionin e pyetësit, do të takojë të anketuarit ballë për ballë për t'u bërë atyre pyetje rreth secilit anëtar të njësisë ekonomike familjare. Përgjigjet do të regjistrohen drejtpërsëdrejti në tabletë sipas një rendi të paracaktuar brenda aplikacionit.

6.2.7 Administrimi i pyetësorëve

Anketuesi do të përdorë mjete shkruese dhe / ose tastierën e ekranit me prekje të tabletës për të regjistruar të gjitha të dhënat në modulet respektive. Listat e zgjedhjeve dhe menutë do të instalohen në tabletë për të lehtësuar punën e anketuesve. Kontrolli dhe parametrat cilësorë të integruar në tablet duhet të garantojnë përputhjen dhe besueshmërinë e informacionit të mbledhur. Përveç kësaj, çdo banesë dhe vendbanim i numëruar do të gjeokodohet nga ndërtesa (ose ndërtesa kryesore për banesat) për të mbledhur vendodhjen e tyre përmes pajisjeve GPS të tabletave. Gjeokodimi do të mbështetet nga specialistët mbështetës GIS të shpërndarë në secilën

bashki gjatë Censit. Sapo të regjistrohen në tablet, të dhënat do të transferohen sa më shpejt të jetë e mundur direkt në bazën qendrore të të dhënave për kontroll dhe miratim.

Përdorimi i tabletit paraqet avantazhet e mëposhtme për veprimtarinë e Censit:

- (a) Kontrollat e miratimit të përfshira në pyetësor;
- (b) Kalimet e automatizuara që çojnë në një progres më të saktë dhe më të shpejtë nëpërmjet pyetësorit;
- (c) Kodifikimi i automatizuar duke siguruar opsione përgjigjeje, të tilla si menutë me zgjedhje;
- (d) Përshtatja e pyetjeve, duke përfshirë mundësinë e administrimit të pyetësorit në gjuhë të ndryshme;
- (e) Reduktimi i gabimeve në hedhjen e të dhënave;
- (f) Zvogëlimi i kohës për shkak të eliminimit të gabimeve në fazën e mbledhjes së të dhënave dhe reduktimit të fazës së editimit dhe hedhjes së të dhënave në sistem. Të dhënat mund të analizohen dhe të shpërndahen më shpejt.
- (g) Reduktimi i kostos për shkak të eliminimit të kostos së printimit, transportit dhe ruajtjes së pyetësorëve letër dhe hedhjes së të dhënave gjatë fazës së kapjes së të dhënave. Megjithatë, rritja e kostove të pajisjeve mund të balancojë kursimet;
- (h) Numri i reduktuar i formave të palidhura;
- (i) Përmirësimi i menaxhimit në terren dhe kontrollit të tij për arsye të kontrollit dhe monitorimit në kohë reale;
- (j) Lehtësuesi i menaxhueshëm;
- (k) Perceptimi pozitiv i të anketuarve që mund të tregojnë një qëndrim më pozitiv dhe bashkëpunues ndaj censit përmes përdorimit të teknologjisë së fundit.

Kontrollorët dhe anketuesit do të trajnohen për përdorimin e tabletave, njohjen e aplikacionit CAPI dhe përdorimin e kontrolleve të konsistencës së brendshme të përfshirë në aplikacion.

6.2.8 Popullata në institucione

Një listë e institucioneve/banesave kolektive që akomodojnë popullsinë në këto banesa do të nxirret paraprakisht për anketuesit e Censit, me mbështetjen e institucioneve përgjegjëse, komisioneve bashkiake si dhe Komisionit Qëndror të Censit.

6.3 Përmbajtja e pyetësorëve

Përmbajtja e pyetësorit të censit do të hartohet duke marrë parasysh prioritetet kombëtare, temat e përcaktuara nga BE, krahasueshmërinë me censet e mëparshme dhe censet e ardhshme bazuar në regjistra, duke siguruar kështu efikasitet operacionale me kosto të arsyeshme.

Një kriter i rëndësishëm për të vendosur për përfshirjen e një çështjeje në Cens do të jetë përdorimi i saj në nivel të vogël gjeografik. Çështjet që përdoren vetëm në nivel kombëtar ose rajonal mund të hulumtohen më mirë në një vërtetim me zgjedhje.

Megjithatë, pyetësi do të pasqyrojë çështje që konsiderohen relevante për prioritetet kombëtare si Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, përsa kohë që nuk janë të mundshme të përcaktohen përmes burime të tjera vërtetimesh ose administrative ose kur treguesit e ofruar mund të jenë bazë për vërtetime të mëtejshme në të ardhmen.

Njësitë statistikore dhe variablat për të cilat INSTAT planifikon të përdorë të dhëna nga regjistrat dhe/ose administrative për përditësimin e statistikave të cens, duhet të përcaktohen në mënyrë që të jetë në përputhje me këto burime të tjera dhe të lejojë harmonizimin mes tyre.

Drafti i parë i çështjeve dhe pyetjeve do të përgatitet nga INSTAT në maj 2018, për t'u diskutuar më tej gjatë pesë konsultimeve të palëve të interesuara nën ombrellën e Këshillit të Statistikave. Përmbajtja përfundimtare e pyetësorit do të jetë në përputhje me Rekomandimet për Censet e Popullsisë dhe Banesave 2020, duke përfshirë të gjitha temat kryesore. Për më tepër, do të përfshihen edhe një pjesë e temave jo-kryesore dhe tema të tjera të rëndësishme për specifikat e vendit dhe përdoruesit e Censit.

Pyetësori do të mbulojë katër nivele të njësive statistikore: individët, njësitë ekonomike familjare, banesat dhe ndërtesat dhe do të mbledhë informacionin që lidhet me këto tema kryesore:

- Vendndodhja;
- Karakteristikat e ndërtesës dhe të banesës;
- Karakteristikat e njësive ekonomike familjare;
- Ish anëtarët e familjes që jetojnë jashtë vendit;
- Karakteristikat e përgjithshme të individit;
- Migracioni;
- Arsimi;
- Aktiviteti ekonomik.

Duke qenë se pyetësori është dokumenti më i rëndësishëm në Census, INSTAT do të organizojë një workshop me ekspertë ndërkombëtarë dhe kombëtarë për të diskutuar përmbajtjen e pyetësorit dhe për ta përmirësuar atë më tej deri në konsolidimin e tij përfundimtar.

Pyetësori do të jetë i disponueshëm në gjuhën shqipe. Versionet më të thjeshta të pyetësorit mund të përdoren për popullata specifike (banesat kolektive, të pastrehët).

Pyetësori do të testohet në terren para Censit pilot, për të vlerësuar kuptueshmërinë e pyetjeve nga popullsia si dhe kohëzgjatjen e intervistës. Formulimi dhe lista e pyetjeve do të shqyrtohen pas testeve.

6.4 Sensitiviteti ndaj gjinisë

Është e rëndësishme që Censi të jetë sensitiv ndaj gjinive në mënyrë që të pasqyrojë me të vërtetë pozitën e burrave dhe grave në shoqëri. Është e rëndësishme të sqarojmë se censi nuk mund të konsiderohet pa gjini vetëm për shkak se mbledh dhe publikon të dhëna për burrat dhe gratë. Sigurimi i të dhënave të ndara sipas gjinisë është një hap i parë i rëndësishëm drejt analizimit të çështjeve gjinore, por jo domosdoshmërisht i mjaftueshëm për analiza gjinore.

Për të siguruar një cens pa paragjykime gjinore, është e rëndësishme që INSTAT-i dhe Komisioni Qendror i Cens të tregojnë angazhimin e tyre. Në këtë drejtim, aktivitetet e mëposhtme do të kryhen para dhe gjatë Cens 2021:

- Të trajnojnë ekipin e censit të INSTAT-it dhe stafin e censit për çështjet gjinore në cens;

- Të përfshijë organizata që merren me çështjet gjinore në konsultimet e pyetësorit të censit;
- Promovojë dhe nxisë rekrutimin e anketuesve, kontrollorëve dhe mbikëqyrësve gra në aktivitetet në terren;
- Të përfshijnë në fushatën e komunikimit aspektet gjinore të censit dhe të synojnë organizatat e grave.
- Reflektojnë çështjet gjinore në programin e tabulimeve, analizën e të dhënave dhe shpërndarjen.

6.5 Dokumentet teknike

Do të prodhohen një seri dokumentesh që lidhen me organizimin, pyetësorët, Censin në terren, logjistikën, verifikimin dhe validimin e të dhënave, kodifikimin dhe imputimin, tabelimin, analizën, prokurimet, rekrutimet dhe publikimin.

Dokumentet do të japin informacion mbi hapat e ndryshëm të veprimtarisë së Censit dhe do të japin një ide gjithëpërfshirëse mbi fushëveprimin e aktiviteteve të planifikuara dhe strategjive të miratuara. Dokumentet e tjera do të japin udhëzime për anketuesit, kontrollorët dhe mbikëqyrësit e tyre për të arritur një kuptim të harmonizuar dhe zbatimin e operacioneve të cens.

Dokumentet teknike të rëndësishme për t'u përgatitur përfshijnë:

- Manualin e udhëzimeve për zyrat rajonale
- Manualin e udhëzimeve për mbikëqyrësit
- Manualin e udhëzimeve për Komisionet Bashkiake të Censit
- Manualin e udhëzimeve për stafin mbështetës të TI
- Manualin e udhëzimeve për stafin mbështetës të GIS
- Manualin e udhëzimeve për kontrollorët
- Manualin e udhëzimeve për anketuesit
- Manualin e udhëzimeve për anketuesit specialë
- Manualin e procedurave të prokurimit
- Manualin e procedurave të rekrutimit.

Manualet e udhëzimeve për stafin e terrenit nuk do të printohen, por instalohen në tableta së pari, si një dokument i pavarur në formatin pdf, dhe së dyti në ndihmën on-line për aplikacionet. Për shembull, aplikacioni i pyetësorit do të përfshijë për çdo ekran pyetje një ikonë me një pikëpyetje për të hapur një dritare me udhëzimet përkatëse dhe informacionin që lidhet me pyetjen (shih kapitullin 9).

6.6 Testet dhe Censi Pilot

Për të qenë të suksesshëm veprimtaria e Censit është e rëndësishme të kryhen teste të ndryshme dhe aktivitete në terren para se të filloj procesi i numërimit të Cens. Për këtë, është planifikuar sa më poshtë:

6.6.1 Testet

Instrumentet dhe mjetet teknike do të testohen në mënyrë sistematike në terren për të patur një tregues fillestar të administrimit të vështirësive në plotësimin e pyetësorëve, si dhe vështirësitë lidhur me interpretimin e manualeve të udhëzimeve dhe procedurave të CAPI (shih kapitullin 9).

Metodologjia konsiston në administrimin e pyetësorit ose një pjesë të tij për të intervistuarit e mundshëm nga shtresa të ndryshme shoqërore. Kjo do të synojë në:

- Testimi i funksionimit korrekt dhe efektiv të tabletave dhe aplikacioneve;
- Vlerësimin e nivelit të kuptimit të pyetësorit nga ana e intervistuesit dhe të intervistuarit;
- Identifikimin e çdo pyetjeje të formuluar keq dhe testimin e zbatueshmërisë së pyetësorit;
- Identifikimin e problemeve që anketuesi mund të hasë në terren gjatë numërimit të cens;
- Matjen e efektivitetit të administrimit të pyetësorëve dhe plotësimin e tyre në terren.

6.6.2 Censi pilot

Censi pilot është një test gjithëpërfshirës i të gjitha procedurave të censit. Karakteristikat thelbësore të një censi pilot janë mbulimi i një ose më shumë ndarjeve administrative të konsiderueshme dhe ekzekutimi i fazave përgatitore, të numërimit dhe përpunimit të të dhënave, me anë të të cilave ai teston përshtatshmërinë e të gjithë planit të censit dhe të organizimit të censit. Për t'i shërbyer më mirë këtij qëllimi, kushtet në censin pilot duhet të jenë sa më afër të jetë e mundur me ato që do të jenë të pranishëm gjatë numërimit aktual. Për këtë arsye, rekomandohet që një cens pilot të bëhet një vit para censit të planifikuar, në përputhje me modelet e pritshme sezonale të klimës dhe kushteve⁵.

Qëllimi kryesor i Censit Pilot është që të provojë në kushte reale hartografinë, metodologjinë, strukturën organizative, sistemin CAPI, planifikimin logjistik dhe ndërveprimin midis të gjitha burimeve të planifikuara për t'u angazhuar në vetë censin aktual. Objektivat e drejtpërdrejta të Censit Pilot janë të:

- kontrollojë efektivitetin e strukturës organizative;
- kontrollojë saktësinë e planifikimit dhe materialit mbështetës logjistik;
- të kryejë një test përfundimtar të pyetësorit në një shkallë të gjerë, veçanërisht të testojë qartësinë e pyetjeve dhe mënyrën se si janë plotësuar;
- të vërtetojë qartësinë dhe gjithëpërfshirjen e udhëzimeve të stafit në terren;
- të qartësojë përdorimin e aplikacionit CAPI për mbledhjen e të dhënave, duke përfshirë përdorimin e funksioneve ndihmëse;
- të verifikojë përdorimin e aplikacioneve të anketuesve, kontrollorëve dhe mbikëqyrësve;
- të verifikojë efektivitetin dhe efikasitetin e procedurave të transmetimit të të dhënave në bazën qendrore të të dhënave;

⁵ Parimet dhe Rekomandimet për Censin e Popullsisë dhe Banesave, Revizioni 3, f.106, Kombet e Bashkuara, Nju Jork, 2015

- të verifikojë efikasitetin e përzgjedhjes së stafit të terrenit dhe metodën e rekrutimit;
- të verifikojë efikasitetin e trajnimit për stafin e terrenit;
- të verifikojë bashkëveprimin midis të gjitha njësive dhe niveleve të përfshira në Cens;
- të verifikojë qarkullimin e informacionit ndërmjet të gjitha niveleve;
- në një fazë të mëvonshme, të verifikojë dhe konsolidojë programin e përpunimit të të dhënave duke përdorur të dhënat e Censit Pilot.

Censi i parë Pilot është kryer në periudhën Tetor-Nëntor 2019 në një kampion prej 100 zonash numërimi, duke përfaqësuar rreth 7000 NjEF si dhe dy banesa kolektive. Censi i dytë pilot do të kryhet në Tetor-Nëntor 2021, i cili sërish do të mund të sigurojë konkluzione mbi përshtatshmërinë e hartografisë, metodologjisë, organizimit, fushatën sensibilizuese, sistemin CAPI si dhe planin logjistik.

Procesi i mbledhjes së të dhënave do të përfundojë brenda 6 javëve, ku një anketues do të jetë përgjegjës për 2 ZC.

Zonat do të përzgjidhen për të përfaqësuar diversitetin e kushteve socio-ekonomike dhe gjeografike të popullsisë në vend, duke siguruar një minimum prej 5 zonash censi në secilën bashki të zgjedhur, për të vëzhguar menaxhimin dhe mbikëqyrjen e operimit në terren në situata reale.

Gjithashtu, kampioni i pilot cens duhet të përfshijë zona që të mundësojnë testimin e metodologjisë dhe të gjitha procedurave që planifikohen të ndiqen në Cens. Në këtë mënyrë, zonat e përzgjedhura për Pilot Cens do të përmbushin këto karakteristika:

1. ZC me këtë numër popullsie si dhe të ndarë në URBAN/RURAL:
 - a. <101 banorë;
 - b. >500 banorë;
 - c. 101-200 banorë;
 - d. 201-300 banorë;
 - e. 301-400 banorë;
 - f. 401-500 banorë.
2. ZC me përbërje popullsie minoritare:
 - a. Grek;
 - b. Aromunë;
 - c. Maqedonas;
 - d. Malazezë;
 - e. Romë;
 - f. Egjiptianë.
3. ZC ku numri i refuzimeve në Cens/anketa të tjera sociale, kanë numër të lartë refuzimesh.
4. ZC në zona kodrinore dhe malore.

Instrumentet e vlerësimit të Censit Pilot do të zhvillohen për të përfshirë treguesit e performancës në lidhje me planifikimin, menaxhimin e operacioneve në terren dhe treguesit që lidhen me cilësinë dhe efikasitetin e pyetësorëve, performancën e tabletëve si mjete pune, qëndrueshmërinë e tyre në terren, transmetimin e të dhënave etj. Rezultatet e Censit Pilot do të

analizohen me kujdes nga INSTAT për të përcaktuar ndryshimet e mundshme për kryerjen e suksesshme të Censit të Përgjithshëm.

6.7 Garantimi i cilësisë

Produkti i çdo censi të popullsisë dhe banesave është informacion statistikor dhe besimi në cilësinë e këtij informacioni është thelbësor. Prandaj, menaxhimi i cilësisë duhet të luajë një rol qendror për Censin e çdo vendi. Një program i menaxhimit të cilësisë është një element thelbësor në programin e përgjithshëm të censit dhe duhet të prekë të gjitha fazat dhe aktivitetet e censit. Qëllimi kryesor është të sigurojë në mënyrë sistematike cilësinë e procesit që në fazat e para nëpërmjet aplikimit të mirë të njohurive dhe ekspertizës nga punonjësit në shumë nivele, dhe nëpërmjet proceseve të përcaktuara të sigurimit të cilësisë dhe rishikimeve. Do të përfshijë gjithashtu komponentë specifik për identifikimin e gabimeve në mënyrë që të ndërmerren veprime korrigjuese gjatë operacioneve të censit. Pa një program të tillë, të dhënat e Censit mund të përmbajnë gabime, të cilat mund të pakësojnë dobishmërinë e rezultateve. Nëse të dhënat janë të një cilësie të ulët, atëherë vendimet e bazuara në këto të dhëna mund të çojnë në gabime të kushtueshme. Përfundimisht besueshmëria e gjithë Censit mund të vihet në pikëpyetje.

Siç rekomandohet ndërkombëtarisht⁶, INSTAT do të zhvillojë një program për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë për të matur cilësinë në çdo fazë të censit. Sistemi i sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë do të zhvillohet si pjesë e programit të përgjithshëm të censit dhe do të integrohet në planet, kalendaret dhe procedurat e tjera të censit. Sistemi do të vendoset në të gjitha fazat e operacioneve të censit, duke përfshirë planifikimin, para-numërimin, numërimin, transmetimin e të dhënave, kodimin, redaktimin, tabelimin, analizën dhe shpërndarjen e të dhënave.

Cilësia duhet të kuptohet si një koncept shumëdimensional, duke përfshirë dimensionet e mëposhtme:

- a) Rëndësia: kuptohet si shkalla në të cilën statistikën plotësojnë nevojat e përdoruesve;
- b) Saktësia: shkalla në të cilën të dhënat vlerësojnë saktë ose përshkruajnë saktë ose karakteristikën që Censi ka si objektiv për të matur;
- c) Krahueshmëria: shkalla në të cilën statistikën janë të krahasueshme në hapësirë dhe kohë;
- d) Koherenca: shkalla në të cilën informacioni i Censit mund të përdoret me sukses së bashku me informacionin statistikor nga burime të tjera të të dhënave (përfshirë regjistrat) brenda një kuadri të gjerë konceptual dhe me kalimin e kohës.
- e) Koha: koha e kaluar midis datës së referencës dhe publikimit të të dhënave;
- f) Disponueshmëria: disponueshmëria e informacionit dhe përshtatshmëria e formatit në të cilin informacioni është i disponueshëm.

⁶ Konferenca e Statistikanteve Europiane, Rekomandimet për Censet e Popullsisë dhe Banesave 2020, Kombet e Bashkuara, Nju Jork dhe Gjenevë, 2015

Plani i sigurimit të cilësisë do të përcaktojë masat e sigurimit të cilësisë për të siguruar secilën nga dimensionet e cilësisë.

6.7.1 Menaxhimi i riskut

Praktikat e mira të menaxhimit të riskut ulin probabilitetin ose pasojat negative të ngjarjeve të padëshirueshme që mund të shkaktojnë vonesa, të rrisin kostot ose rrezikojnë arritjen e objektivave.

Menaxhimi i riskut kërkon identifikimin e risqeve të mundshme, përcaktimin e probabilitetit të shfaqjes së tyre dhe vlerësimin e ndikimeve të mundshme në një projekt. Kombinimi i probabilitetit të ndodhjes dhe impakteve të mundshme lejon që risqet të klasifikohen sipas rëndësisë së tyre. Një risk që ka një probabilitet të ulët të ndodhjes dhe ka ndikime të kufizuara do të klasifikohet si i vogël, ndërsa një risk me probabilitet të lartë të shfaqjes dhe ndikim të lartë do të konsiderohet i madh. Një ose më shumë veprime parandaluese ose korrigjuese duhet të përcaktohen për çdo risk të identifikuar.

INSTAT është në proces të zhvillimit të një plani të menaxhimit të riskut për projektin e Censit, i cili do të rishikohet dhe përditësohet gjatë çdo faze të zbatimit të projektit. Bordi i Menaxhimit të Cilësisë së Censit do të monitorojë dhe përditësojë matricën e riskut. Një ekspert ndërkombëtar do të kontraktohet për të mbështetur përgatitjen e menaxhimit të riskut dhe planin e detajuar të veprimit.

6.8 Anketa Pas Censit (APC)

6.8.1 Objektivat

Mbledhja e informacionit në lidhje me popullsinë dhe banesat aktualisht është më mirë e kontrolluar falë progresit teknologjik. Megjithatë, gabime sasiore dhe cilësore janë ende të mundshme në operacionet e Censit të popullsisë. Gabimet më të rëndësishme sasiore janë ato që lidhen me mbulimin. Këto janë gabimetë shkaktuar nga mosnumërimi i plotë i popullsisë dhe banesave. Gabime të tjera mund të lidhen me dublikimet e mundshme si dhe numërimin e dyfishtë. Këto gabime mund të lindin për shkak të problemeve në fazën e hartimit të veprimtarisë së Censit, zbatimit të fazave përgatitore ose gjatë punës në terren. Për të vlerësuar madhësinë e këtyre gabimeve, një anketë pas numërimit do të kryhet menjëherë pas Censit.

Anketa e Pas Cens (APC) është një operacion i pavarur. Krahasuar me censin, APC ofron mundësinë për të llogaritur nivelin e besueshmërisë ose cilësinë e të dhënave të mbledhura, duke përdorur një model statistikor.

Rezultatet e APC do të bëjnë të mundur vlerësimin e mbulimit të popullsisë në cens në nivel kombëtar dhe ndoshta në nivel urban dhe rural dhe të cilësisë të disa karakteristikave të përzgjedhura të popullsisë. Objektivat specifike të Anketës Pas Cens-it janë:

- Vlerësimi sasior i mbulimit të cens;
- Vlerësimi i cilësisë së karakteristikave të përzgjedhura të matura në cens;
- Mbledhja e informacionit mbi burimet e gabimeve gjatë cens;
- Të shërbejë si bazë për të përmirësuar cilësinë e të dhënave në numërimet e ardhshme;

- Të shërbejë si bazë për vlerësimin e kriterreve të korigjimit, p.sh. për të përmirësuar projeksonet demografike dhe parashikimet e popullsisë nëpërmjet Censeve.

6.8.2 Metodologjia e APC

APC është një anketë e tillë që do të mbulojë një numër të kufizuar, por përfaqësues të njësive ekonomike familjare të vendosura në ZC-të e përzgjedhura rastësisht në territorin e vendit. Kampioni do të përzgjidhet në mënyrë rigoroze paraprakisht duke marrë në konsideratë zonat e ndryshme gjeografike dhe administrative të vendit për të siguruar rezultate të rëndësishme në nivel kombëtar dhe ndoshta në nivel urban/rural. Gjeografia e censit do të përdoret si një kornizë për përzgjedhjen e kampionit.

Teknikat e numërimit do të ndjekin ato të censit, për të garantuar krahasueshmërinë e të dhënave ndërmjet dy operacioneve. Ashtu si në cens, popullsia do të llogaritet bazuar në vendbanimin e saj të zakonshëm.

Metoda e mbledhjes së të dhënave është intervista direkte. Anketuesit e trajnuar paraprakisht do të vizitojnë njësitë ekonomike familjare rezidente në zonat e caktuara për t'u bërë pyetjet e planifikuara të intervistuarëve. Përgjigjet do të hidhen në tabletë në pyetësorët e zhvilluar për këtë qëllim.

APC do të fillojë dy javë pas përfundimit të censit të përgjithshëm dhe do të zgjasë tre javë. Një anketues do të mbulojë të gjitha njësitë ekonomike familjare që banojnë në ZC të caktuar të tij/saj.

Metodologjia dhe procedurat e APC do të testohen në terren dhe do të pilotohen në lidhje të ngushtë me testet e Censit dhe pilotët, por të - por të pavarura nga ato.

6.8.3 Plani i kampionit

APC i Censit 2011 përfshiu 105 zona numërimi të zgjedhura rastësisht, të stratifikuara sipas klasifikimit të tyre si urban ose rural. Madhësia e kampionit lejon prodhimin e vlerësimeve të mbulimit të censit në nivel kombëtar dhe urban/rural.

Për të siguruar pavarësinë e plotë midis censit dhe APC kampioni do të nxirret vetëm pas përfundimit të Censit.

6.8.4 Stafi në terren

Për të siguruar përzgjedhjen e duhur, anketuesit dhe mbikëqyrësit e APC do të përzgjidhen midis stafit në terren të Censit, por do të punojnë në një zonë tjetër nga ajo që ishin caktuar në Cens.

Mbikëqyrja e APC në terren do të bëhet në dy nivele. Niveli i parë përfshin teknikë dhe drejtues të Zyrave të INSTAT. Niveli i dytë është mbikëqyrja në terren. Detyrat kryesore të tij / saj janë:

- Koordinimi i aktiviteteve të mbledhjes së të dhënave në ZC të përzgjedhura;
- Kontrolli dhe mbikëqyrja e punës së anketuesve;
- Menaxhimi i materialit që i ofrohet ekipit të tij / saj në terren;
- Kontrolli i të dhënave të mbledhura dhe transmetimi i tyre në bazën qendrore të të dhënave.

Specialistët ndihmës të TIdo të ndihmojnë anketuesit dhe mbikëqyrësit.

6.8.5 Përdorimi i të dhënave

Për të vlerësuar shkallën e mbulimit të censit, të dhënat e njësive ekonomike familjare dhe të banesave nga censi dhe APC do të përputhen për ZC-të korresponduese dhe krahasohen, duke përdorur modelin e Vlerësimit të Sistemit të Dyfishtë⁷. Në një fazë të dytë, për njësitë ekonomike familjare të krahasuara, përgjigjet ndaj një përzgjedhjeje pyetjesh do të krahasohen me vlerësimin e saktësisë së përgjigjeve (gabimet në përmbajtje).

Procedura e krahasimit do të kryhet në mënyrë elektronike, duke krahasuar të dhënat e mbledhura nga Censi dhe APC. Rastet e papërputhshmërisë do të zgjidhen manualisht, duke përdorur një aplikacion vizualizimi. Mundësia për të përdorur përputhjen e mundshme do të merret parasysh.

Një raport do të përgatitet nga INSTAT për të paraqitur metodologjinë e përdorur, zbatimin dhe rezultatet në drejtim të treguesve të saktësisë së mbulimit dhe përmbajtjes së Cens.

7. Gjeografia e Censit dhe informacioni gjeohapësinor

7.1 Rëndësia ndër-sektoriale e të dhënave gjeohapësinore

Siç theksohet në “Rekomandimet për Censin e Popullsisë dhe Banesave 2020 të Konferencës së Statisticienëve Europianë”⁸ dhe në “Parimet dhe Rekomandimet për Censin e Popullsisë dhe Banesave: Raundi i 2020”⁹ i Kombeve të Bashkuara, teknologjia gjeohapësinore pritet të luajë një rol shumë të rëndësishëm në veprimtarinë e Censit kombëtar, që nga aktivitetet përgatitore tek publikimi dhe shpërndarja e rezultateve të Censit. Hartografia ka qenë gjithmonë një pjesë integrale e numërimit në Cens, për të garantuar dhe maksimizuar mbulimin, rritur cilësinë e të dhënave të mbledhura dhe për të përmirësuar publikimin e rezultateve të Censit. Por sot, teknologjia në dispozicion e kombinuar me metodat e reja të cens ofron mundësinë për të zhvilluar një strategji më ambicioze dhe të qëndrueshme për hartografinë e Censit.

Informacioni gjeohapësinor në veprimtarinë e censit është gjithashtu instrument edhe për aktivitete të tjera statistikore, siç është ndërtimi i një kornize të re të kampioneve për anketat dhe vrojtimit pranë njësive ekonomike familjare, krijimi i një regjistri kombëtar të ndërtesave dhe banesave, përmirësimi i mbulimit dhe cilësisë së adresave në njësitë e qeverisjes vendore apo pasurimi i Infrastrukturës Kombëtare të të Dhënave Hapësinore (IKDHH) me skema dhe standarde të reja hapësinore. Operacionet e lidhura me censin gjithnjë e më shumë përkrahin projekte të tjera gjeohapësinore kombëtare dhe ndihmojnë në prodhimin e të dhënave për njësi më të vogla që mund të mbështesin politikat e qeverisjes Lokale.

⁷ Shihni për shembull: Divizioni i Statistikave të Kombeve të Bashkuara, Sondazhet pas Censit, Udhëzimet Operacionale, Raporti Teknik, Nju Jork, 2010

⁸ Konferenca e Statisticienëve Europiane, Rekomandimet për Censet e Popullsisë dhe Banesave 2020, Kombet e Bashkuara, Nju Jork dhe Gjenevë, 2015

⁹ Parimet dhe Rekomandimet për Censet e Popullsisë dhe Banesave: Raundi i vitit 2020 - Revizioni 3, Kombet e Bashkuara, Nju Jork 2015

Progresi në integrimin e të dhënave gjeohapësinore dhe statistikore është gjithashtu një nga objektivat kryesore të Menaxhimit Global të Informacionit Gjeohapësinor (UN-GGIM), një iniciativë botërore në nivel qeveritar, e krijuar së fundmi. Raundi i Censeve 2020 dhe Agjenda e 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm konsiderohet nga UN-GGIM udhëzues të rëndësishëm për integrimin e informacionit gjeohapësinor dhe statistikor në mbështetje të vendimmarrjes së bazuar në fakte në shumë sektorë ¹⁰.

7.2 Një strategji e Gjeografisë së Censit të ardhshëm dhe më tej

Në të kaluarën, INSTAT ka zhvilluar kapacitete të brendshme të rëndësishme në teknikat hartografike (hartografia digjitale) dhe sot zotëron një gjeodatabazë me gjeoinformacion gjithëpërfshirës në nivel ndërtesash për përdorim statistikor. Për Censin e Popullsisë dhe Banesave, janë planifikuar hapa shtesë relevant për të përmirësuar dhe forcuar më tej informacionin e disponueshëm gjeohapësinor për përdorim statistikor në Shqipëri, duke marrë parasysh gjithashtu zhvillimet e fundit të rëndësishme në kontekstin evropian dhe atë shqiptar. Në nivel Evropian, kjo i referohet, për shembull, Direktivës INSPIRE¹¹ të BE-së (Infrastruktura për Informacion Hapsinor në Europë), ndaj disa iniciativave të ndërmarra nga Eurostat në mbështetjen e përdorimit të gjeodateve dhe gjeokodifikimit të statistikave¹², siç janë GISCO, GEOSTAT, DEGURBA, LUCAS, Statistikat rajonale dhe të rrjetit/të qelizave. Në kontekstin shqiptar kjo i referohet Reformës Administrativo-Territoriale të vitit 2015, krijimit së fundmi të Autoritetit Shtetëror Shqiptar për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)¹³, përpjekjet e bëra nga qeveria dhe donatorët ndërkombëtarë për të zhvilluar në Shqipëri një sistem adresash, si dhe punën e Agjencisë së Planifikimit të Territorit, përgjegjëse për Planin Kombëtar dhe koordinimin e Planeve të Përgjithshme Lokale.

Për më tepër, INSTAT vendosi që Censi i ardhshëm do të vendosë bazat për zhvillimin e një regjistri të ndërtesave dhe banesave për përdorim statistikor, në përputhje sa më shumë të jetë e mundur me të dhëna të tjera gjeohapësinore kombëtare dhe regjistra të tjerë statistikorë, siç rekomandohet ndërkombëtarisht dhe që tashmë është implementuar në vende të tjera evropiane. Objektivi kryesor i regjistrit statistikor të ndërtesave dhe banesave do të jetë krijimi i kushteve bazë, së bashku me ndërtimin e një regjistri të popullsisë, për rritjen e përdorimit të të dhënave administrative në prodhimin statistikor dhe statistikave të ardhshme të Censit bazuar në regjistra.

Në konsultim me Ministrinë dhe Agjencitë të tjera shqiptare, INSTAT ka filluar të punojë për të përcaktuar një strategji gjithëpërfshirëse gjeografinë e Censit të ardhshëm, të integruar me planin për zhvillimin e një regjistri statistikor të ndërtesave dhe banesave. Ky aktivitet do të prodhojë një dokument mbi "Strategjinë e Gjeografisë së Censit dhe Regjistrin të Ndërtesave dhe

¹⁰ Komiteti i Ekspertëve mbi Menaxhimin e Informacionit gjeohapësinor Global (2017), Integrimi i informatave gjeohapësinore, statistikore dhe informacione të tjera të ngjashme, E / C.20 / 2017/9 / Add.1.

¹¹ <https://inspire.ec.europa.eu/>

¹² <http://ec.europa.eu/eurostat/web/gisco/overview>

¹³ Siç përcaktohet në Ligjin Nr. 72/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë"

Banesave", duke adresuar objektivat, fazat e zbatimit, qasjet metodologjike dhe përdorimin e teknologjisë, si dhe lidhjet dhe sinergjitë me aktivitetet e tjera gjeohapësinore në Shqipëri.

Në terma të përgjithshëm, INSTAT planifikon të miratojë për aktivitetet e Gjeografisë së Censit, një sistemit të integruar elektronik të përbërë nga mjetet e Sistemit të Informacionit Gjeografik (GIS), Sistemet Globale të Navigimit Satelitor (GNSS) dhe tableta për aktivitetet e përditësimit të hartave, përditësimin e kufijve të ZC, numërimin e ndërtesave dhe banesave, dhe listimin e njësive ekonomike familjare. Sistemi gjithashtu synon të lidhet me aplikacionin CAPI që do të zhvillohet për procesin e numërimit dhe për të mbështetur aktivitetet e menaxhimit dhe monitorimit në terren. Sistemi do të mbështesë përgatitjen dhe zbatimin e Anketës së Post Cens (APC) dhe shpërndarjen e rezultateve të Censit, duke përfshirë sigurimin e të dhënave gjeohapësinore dhe instrumentave për përdorim nga Bashkitë.

Një nga karakteristikat kryesore të sistemit do të jetë integrimi ndërmjet të dhënave gjeohapësinore dhe të dhënave të Censit në nivel pike, të gjeokodifikuara nëpërmjet identifikuesve unik, koordinatave gjeografike dhe potencialisht nëpërmjet adresave të rrugëve, kodeve postare ose të dhënave kadastrale, aty ku është e mundur. Karakteristikat e tilla do të lejojnë grupimin e të dhënave të Censit në çdo dimension hapësinor, nga zonat e vogla si fshatrat, lagjet ose njësitë administrative, deri tek bashkitë ose rajonet, si dhe në nivelin e rrjetit të qelizave (gride) me koordinata. Pasi të sigurohet ruajtja e konfidencialitetit të të dhënave, të dhënat e zonave të vogla të Censit të gjeokoduara mund të përdoren nga administratat lokale dhe rajonale për qëllime të planifikimit dhe të politikbërjes.

Në paragrafët e mëposhtëm, aktivitetet e planifikuara të Gjeografisë së Censit paraqiten sipas fazave kryesore: aktivitetet për fazën e para-numërimit, për fazën e numërimit dhe për fazën pas numërimit. Gjithashtu, adresohen edhe implementimi i planifikuar i regjistrit statistikor të ndërtesave dhe banesave në sinergji me sistemin kombëtar të adresave.

7.3 Aktivitetet e Gjeografisë së Cens-it në fazën e para-numërimit

7.3.1 Përkufizimi i gjeografisë së Cens

Gjeografia e censit është ndarja e të gjithë territorit në njësi të vogla për qëllime të censit. Qëllimi i tij është të përcaktojë një hierarki të njësive administrative, gjeografike dhe statistikore për të cilat mbledhen të dhënat e Censit si dhe publikimin e të dhënave dhe shpërndarjen për disa prej tyre. Përcaktimi i gjeografisë së Censit është një aktivitet i rëndësishëm që duhet të zbatohet kohë më herët gjatë fazës së para-numërimit, për të siguruar që të gjitha njësive statistikore (ndërtesat, banesat, njësitë ekonomike familjare dhe individët) tu sigurohet një mbulim i plotë gjatë periudhës së numërimit. Ai mbështet përkufizimin e zonave operacionale (zonat e numërimit dhe kontrollit) për mbledhjen e të dhënave, lehtëson organizimin dhe menaxhimin e vetë Censit, dhe kur është i organizuar në një mjedis GIS, ofron një kornizë digjitale të përshtatshme për kryerjen dhe monitorimin e punës në terren dhe për publikimin e të dhënave në nivel lokal dhe në njësi më të vogla.

Ndarja aktuale territoriale e Shqipërisë bazohet në Ligjin e vitit 2014 "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"¹⁴. Legjislacioni e ndan vendin në dy nivele administrative: Rajonet (Qarqet) dhe Bashkitë. Sot, janë 12 Qarqedhe 61 Bashki të reja, të cilat përgjithësisht përbëhen nga bashkitë dhe ish komunat që janë të grupuara për të formuar bashkitë e reja. Ish Bashkitë dhe ish Komunitat (në fuqi gjatë Censeve të 2001 dhe 2011) vazhdojnë të ekzistojnë si njësi përbërëse të bashkive të reja nën emërtimin "Njësi Administrative". Emrat zyrtarë të Rajoneve, Bashkive, qyteteve dhe fshatrave përcaktohen me ligj. Megjithatë, ligji i ri nuk përcakton qartë dhe nuk klasifikon ndarjen e territorit në zona urbane dhe rurale.

Gjeografia e Censit do të përbëhet nga njësitet territoriale dhe administrative të lartpërmendura dhe nga zonat operationale të përcaktuara në secilën bashki për organizimin e numërimit: zonat e mbikëqyrësit të menaxhuara nga mbikëqyrësit bashkiak, zonat e kontrollorit, zonat e Censit (ZC).

Pas rishikimit dhe përditësimit të kufijve administrativë me kodet e reja të bazuara në Reformën Territoriale dhe Administrative 2014-2015, aktiviteti i parë i komponentit të hartografisë së Censit do të jetë organizimi dhe përditësimi i hartave në nivel ndërtesë në të gjithë territorin e Shqipërisë. Censi i Shqipërisë i vitit 2011 numëroi pothuajse 1,000,000 ndërtesa në vend, të përdorura për qëllime rezidenciale (606,359) dhe jo rezidenciale. Numri i përgjithshëm i banesave ishte 1,021,330. Që nga viti 2011, një numër i rëndësishëm ndryshimesh pritet të kenë ndodhur në vend, më shumë të lidhura me modifikimet e objekteve ekzistuese ose me ndërtesat e prishura sesa me ndërtimin e ndërtesave të reja, për shkak të masave restriktive të marra nga qeveria në vitet e fundit në dhënien e lejeve të ndërtimit dhe tolerimi i ndërtimeve pa leje.

7.3.2 Rezultatet paraprake të përditësimit të hartës

Nga qershori deri në dhjetor 2017, INSTAT nisi të përditësojë hartat e Censit në 2,247 zona të numërimit, rreth 20% të numrit të përgjithshëm të ZC-ve të Censit të vitit 2011. Përditësimi u krye nga anketuesit e kontraktuar, duke përdorur hartat të printuara në format letër. Për çdo ndërtesë u mblodhën informacionet e mëposhtme:

- Identifikuesit gjeografikë (kodet e bashkisë, ZC, ndërtesat);
- Statusi i ndërtesës (ndërtesë e re, ndërtesa që nuk ekziston më, ndërtesë e modifikuar në formë ose madhësi, godinënë proces ndërtimi);
- Numri i kateve dhe prania e bodrumit;
- Numri i hyrjeve;
- Numri dhe kodet e njësive të klasifikuara si banesa, njësi të përdorura për qëllime biznesi apo për qëllime të tjera.

Të dhënat gjeohapësinore në hartat e formatit të printuar në letër u transferuan në gjeo-databazën e INSTAT-it nga operatorët GIS, ndërsa të dhënat e tjera në pyetësorë u hodhën në një bazë të

¹⁴ Ligji Nr. 115/2014 "Për ndarjen administrative-territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë".

dhënash të veçantë. Në një fazë të mëvonshme, njësia gjeohapësinore do t'i lidhë ato me ndërtesat përkatëse në GIS.

Përditësimi i hartave të vitit 2017 ishte një aktivitet i rëndësishëm për të mbledhur një sërë të dhënash të reja gjeohapësinore për vlerësimin dhe planifikimin e ngarkesës së punës që pritet për përditësimin e përgjithshëm të plotë të hartave. Disa nga rezultatet paraprake të këtij ushtrimi të parë tregojnë se nga 177,820 ndërtesa të marra në shqyrtim, 22,7 %përfshijnë një numër të ndryshëm të banesave krahasuar me vitin 2011 (13,2% me më shumë banesa dhe 9,5% me më pak banesa); 5.3 %janë ndërtesa të reja, ndërsa 2.8 %e ndërtesave janë shkatërruar. Këto rezultate paraprake konfirmojnë se ndryshimet në strukturën fizike të ndërtesave janë shumë të zakonshme, ndërsa numri i ndërtesave të reja në Shqipëri është relativisht i ulët, sigurisht më pak i rëndësishëm se në dekadën midis 2001 dhe 2011.

Megjithëse përditësimi i hartave të vitit 2017 u përqëndrua kryesisht në zonat urbane, analiza paraprake tregon diferenca të rëndësishme dhe heterogjene në madhësinë e ZC gjatë gjashtë viteve të shqyrtuara. Dallimet në madhësinë e ZC ndërmjet banesave dhe njësive ekonomike familjare janë kryesisht të lidhura me përqindjen e lartë (rreth 30%) të banesave vakante (boshe) të regjistruara në Censin e vitit 2011. Prandaj, duke marrë parasysh reduktimin e parashikuar në censin e vitit 2021 të numrit të anketuesve (nga 11,775 në rreth 6,000) dhe synimin për të harmonizuar më mirë madhësinë e ZC për të përfshirë përafërsisht 150 njësi ekonomike familjare, rishikimi i kufijve të ZC është një aktivitet i domosdoshëm dhe relevant, edhe pse kërkon shumë kohë duhet të fillojë në të ardhmen e afërt.

Menjëherë para fazës së numërimit të Censit, hartat e ZC në disa zona specifike, veçanërisht në skajet e territorit të urbanizuar, mund të përditësohen përsëri për të përfituar vlera sa më përafërta për numrin real të ndërtesave dhe shpërndarjen e tyre sa më pranë Ditës së Censit.

Përdorimi i pajisjeve elektronike në vend të hartave në formatin e printuar në letër në Censdo të sigurojë që procesi i mbledhjes së të dhënave të bëhet sipas planit dhe të përmbushë përgjegjësitë dhe kërkesat për aktivitetet e censit. Kjo do të reduktojë kohën dhe shpenzimet në fazat e Censit të tilla si mbledhja e të dhënave, hedhja e të dhënave, editimi i të dhënave; përditësimin të dhënave gjeografike drejtpërsëdrejti nga terreni; monitorimin dhe mbështetjen e veprimeve të anketuesve në terren për gjeokodifikimin e ndërtesave dhe banesave.

7.3.3 Shtyrja e Regjistrimit dhe ndikimi në bazën e të dhënave

Databaza e informacionit gjeohapësinor është përditësuar në vitin 2019 dhe shtyrja e Censit ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e të dhënave. Ndikimet e mundshme lidhen me zbatimin e aktivitetit të projektit SALSTAT mbi Regjistrin Statistikor të Ndërtesave dhe Banesave. Risku kryesor është pasja e një informacioni hapësinor të papërditësuar për Censin 2022 si psh: mungesa e ndërtesave të prishura ose mungesa e ndërtesave të shtuara rishtas. Si rezultat i zonave të Censit të papërditësuara, mund të rritet risku i mos mbulimit të **zonës** ose mbulimit të tepërt të saj dhe të ndikojë në ngarkesën e punës së anketuesve gjatë procesit të **Censit**. **Për të mbajtur një gjeodatabazë të të dhënave të përditësuara**, për të parandaluar **riskun** e **mos mbulimit të zonës** së Censit ose mbulimin e **tepërt** i saj duhet të konsiderohet të kryhen të paktën dy

përditësime të tjera të hartave në zona të veçanta, veçanërisht në qytetet kryesore dhe në kufijtë e zonave të urbanizuara.

7.3.4 Përditësimi kompjuterik i GIS

INSTAT planifikon të kryejë përditësimin e hartave në terren me një aplikacion, të ngarkuar në tableta dhe të sinkronizuar me bazën e të dhënave të INSTAT-it. Një aplikacion i tillë pritet të përfshijë instrumenta editimi për të rikonfiguruar për shembull konturet e ndërtesave, për të shtuar poligone të reja, që përfaqësojnë ndërtesa të reja, për të fshirë ndërtesat që nuk ekzistojnë më, për të bashkuar ndërtesa të ndara, për të përditësuar karakteristikat e ndërtesave si p.sh. numrin e kateve, hyrjet e ndërtesës, numrin e ndërtesave për qëllime banimi ose biznesi, kodet dhe adresat e tyre, etj.

Aplikacioni duhet të zhvillohet me një seri rregullash logjike që përmirëson cilësinë e operacioneve të përditësimit të hartave. Anketuesit duhet të lejohen të zgjedhin shtresa të ndryshme GIS për të edituar (shtresa e ndërtesave, shtresa e rrugëve, shtresa e pikave të referimit), dhe brenda çdo shtrese çdo funksion hapësinor. Aplikacioni për përditësimin e hartave të ZC-ve është konceptuar për t'u përdorur jo vetëm për projektin e Cens 2021, por edhe për aktivitetet e ardhshme statistikore të INSTAT-it, për shembull për të mbështetur përgatitjen e anketave dhe vrojtimeve të bazuara në kampione dhe për përditësimin e regjistrit statistikor të ndërtesave dhe banesave.

7.3.5 Përgatitja e terrenit për një regjistër ndërtesash dhe banesash

Në qasjet e gjeokodimit, preferohet të zhvillohet një sistem statistikor

i të dhënave statistikore të gjeokodifikuara i bazuar në të dhënat në nivel pike, - që është gjithashtu më i përshtatshëm për një Cens të ardhshëm bazuar në regjistër. Kjo do të thotë se vendndodhjet e ndërtesave ose banesave janë specifikuar duke përdorur identifikues unikë dhe koordinata gjeografike, duke dhënë vendndodhjen e saktë të çdo njësie statistikore. Përdorimi i identifikuesve unikë në nivel pike (p.sh. centroidet e ndërtesës dhe adresat) dhe koordinatat për ndërtesat dhe adresat mund të hapin rrugën për një përcaktim më fleksibël të njësive hapësinore të zonave të vogla për qëllime të zhvillimit lokal. Qasja e gjeokodimit në nivel pike gjithashtu rekomandohet për statistikatat në nivel rrjeti qelizash (grid).

Nga përvoja e vendeve të tjera, një regjistër i tillë duhet të menaxhojë të dhënat për ndërtesat që përdoren për qëllime rezidenciale dhe të dhëna opsionale për ndërtesat e përdorura për qëllime të tjera, të ndryshme nga ai i banimit. Përfitimi i menjëhershëm është të kontribuojë në modernizimin e sistemit statistikor, përmirësimin e cilësisë dhe mbështetjen e vrojtimeve statistikore. Në hartimin e saj, do të jetë gjithashtu e rëndësishme që të krijohen procedura dhe identifikues të përbashkët për lidhjen me regjistrat e tjerë, që janë tashmë në dispozicion në vend apo janë planifikuar të ndërtohen. Një nga aspektet kryesore që kërkon hulumtim të mëtejshëm është sistemi i kodimit për identifikuesit unikë dhe përkufizimi i një fjalori statistikor zyrtar për njësitë vendore, për të arritur harmonizimin dhe/ose përcaktimin e çelësave të kalimit ndërmjet regjistrave të ndryshëm dhe grupeve të të dhënave administrative dhe statistikore.

Sistemi shqiptar i adresave është duke u vendosur ndërtesave një adresë zyrtare. Në terma të përgjithshëm, ky sistem përbëhet nga emri i pronarit të njësisë së banimit (është shoqëruar një numër identifikimi personal - NIP), emri i rrugës, numri i ndërtesës, hyrja e ndërtesës,

qyteti/fshati, kodi postar, bashkia. Përgjatë rrugëve, ndërtesave u janë vendosur numra, përkatësht në anën e majtë u vendosen numra tek dhe në anën e djathtë u vendosen numra çift, duke nisur nga fillimi i rrugës në afërsi të qendrës së qytetit.

Aktualisht, sistemi i identifikimit të ndërtesave të përdorura nga sistemi i adresarit shqiptar paraqet shumë diferenca krahasuar me atë të përdorur nga INSTAT për qëllime statistikore. Madje, edhe numrat e ndërtesave dhe numrat e kateve të përdorura në të dy sistemet janë caktuar me metodologji të ndryshme. INSTAT po diskuton me Ministrinë e Brendshme për të krijuar një sinergji midis dy sistemeve të kodimit dhe po shqyrton mundësinë e përfshirjes në aktivitetet e përditësimit të ZC-ve në mbledhjen e informacionit për adresat, e planifikuar për vitin 2019. Një Memorandum Mirëkuptimi do të nënshkruhet ndërmjet dy institucioneve për të përcaktuar detajet e bashkëpunimit.

7.4 Aktivitetet e Gjeografisë së Censit në fazën e numërimit

Gjatë operacioneve në terren, shkalla e mbulimit të cens mund të rritet jo vetëm përmes një përkufizimi të saktë të gjeografisë së cens-it dhe skicimit të saktë të njësive administrative dhe zonave të Censit. Gjithashtu është e rëndësishme të mbështetet orientimi në terren i anketuesve. Çdo anketues në përgjithësi pajiset me një ose më shumë harta të ZC-ve, ku paraqiten në detaje të gjitha ndërtesat ku mund të banojnë njësitë ekonomike familjare ose ku mund të gjenden njësitë e biznesit. Hartat e ZC-ve janë një mjet për anketuesit që të sigurojnë që gjatë fazës së numërimit të gjitha ndërtesat, përhershme ose jo, të ndërtuara për qëllime rezidenciale dhe jo-rezidenciale, janë vizituar për të identifikuar dhe intervistuar njësitë ekonomike familjare, dhe / ose për të lokalizuar dhe kategorizuar njësitë e biznesit. Gjithashtu, hartat e ZC-ve shërbejnë për monitorimin e mbulimit të zonave që iu janë caktuar anketuesve. Sistemi i kodimit/identifikimit i paraqitur në hartat ZC duhet të jetë në përputhje me kodet identifikuese të paraqitura në pyetësorët e Cens-it si dhe format e tjera të raportimit. Kur lidhjet e drejtpërdrejta midis njësive të Cens-it dhe hartave vendosen në mënyrë elektronike në terren, shkalla e mbulimit të Cens-it rritet (p.sh. në teknikat CAPI ku funksionet e GPS-it janë aktivizuar).

INSTAT ka në plan të zhvillojë një aplikacion elektronik për menaxhimin në terren të stafit dhe materialeve, si dhe të monitorojë operacionet në terren në kohë reale nëpërmjet një mekanizmi gjurmues bazuar në funksionet GPS në tabletat e anketuesve. INSTAT do të mundësojë të lokalizojë nga zyrat vendndodhjen e stafit të terrenit, të monitorojë mbulimin e numërimit për ZC dhe për ndërtesë, dhe në të njëjtën kohë të kontrollojë progresin në terren. Mbështetja në terren për gjeokodimin e të dhënave të censit do të sigurohet nga specialistët mbështetës GIS. Ata priten të marrin pjesë në trajnimin e stafit në terren, për të mbështetur anketuesit dhe kontrollorët për të mbledhur të dhënat GPS, për të mbështetur orientimin e anketuesve dhe kontrollorëve në zonat e tyre të Cens-it dhe për të monitoruar mbledhjen e saktë të të dhënave mbi adresat.

7.5 Aktivitetet e Gjeografisë së Cens-it në fazën pas Cens

INSTAT ka në plan të përdorë mjetet GIS dhe GNSS edhe për organizimin dhe kryerjen e Anketës pas cens (PES) pas përfundimit të operacioneve të mbledhjes së të dhënave.

Teknologjia gjeohapësinore do të përdoret për përgatitjen e hartave të ZC të përzgjedhura dhe për menaxhimin e operacioneve në terren. Integrimi i të dhënave të anketes pas cens (PES) në bazën e të dhënave gjeo do të mbështesë krahasimin midis regjistrimit të cens dhe rezultateve të anketës pas cens të njësive të mbuluara në ZC kampion. INSTAT ka në plan të përdorë mjetet GIS dhe GNSS edhe për organizimin dhe kryerjen e Anketës pas Cens (APC) pas përfundimit të mbledhjes së të dhënave të censit. Teknologjia gjeohapësinore do të përdoret për përgatitjen e hartave të ZC-ve të përzgjedhura dhe për menaxhimin e veprimtarive në terren. Integrimi i të dhënave të anketës pas Cens (APC) në bazën e të dhënave gjeografike do të mbështesë krahasimin midis të dhënave të mbledhura gjatë Censit dhe rezultateve të anketës pas Censit (APC) për çdo njësi në kampion.


Publikimi i të dhënave të Cens-it (shih kapitullin 10 mbi shpërndarjen dhe analizën) përfshin përgatitjen e hartave tematike dhe analizave gjeohapësinore. Nëse hartat përgatiten me funksionalitetet GIS, ato janë një mënyrë e rëndësishme dhe efikase për publikimin dhe shpërndarjen e rezultateve të censit. Ato mund të përdoren për të prodhuar harta tematike, si në format dixhital ashtu dhe të printuara, atlase censi si dhe për aplikacionet e hartave në web (p.sh. WebGIS ose Portale). Hartat gjithashtu janë të dobishme për të kryer analiza gjeo-hapësinore duke kombinuar variablat për të shqyrtuar marrëdhëniet dhe për t'i prezantuar aty ku ato ndodhin.

8. Censi në teren

8.1 Organizimi i censit në terren

Njësia e Censit (e përbërë nga Grupi Teknik dhe Grupi i Operacional i Censit) është subjekti kryesor i planifikimit, organizimit dhe realizimit të numërimit në terren. Struktura përfshin Zyrat Rajonale të Censit, Zyrat Bashkiake në Terren dhe stafin e terrenit (mbikëqyrësit, kontrollorët dhe anketuesit).

Figura 3: Organizimi i numërimit të Censit



8.1.1 Zyrat rajonale

Struktura organizative përfshin një Zyrë Rajonale të Cens në Zyrën Rajonale të INSTAT-it.

Detyrat e Zyrave Rajonale janë:

- Marrin pjesë në trajnimin e mbikëqyrësve;
- Përgatisin dhe monitorojnë operacionet e mbledhjes së të dhënave në rajon;
- Kontrollon punën e Zyrave Bashkiake të Terrenit;
- Krijonë, brenda Prefekturës, kontaktin e nevojshëm me autoritetet, mediat dhe publikun në përgjithësi, për të lehtësuar aktivitetet e Censit;
- Marrin pjesë në mënyrë aktive në promovimin e Censit dhe fushatës ndërgjegjëse në Prefekturë;
- Sigurojnë që të gjitha tabletat, pajisjet dhe materialet, të përdorura ose të papërdorura, të transferohen në zyrat qendrore të INSTAT-it në fund të punës së mbledhjes së të dhënave.

8.1.2 Kategoritë e stafit në terren

Nën udhëheqjen e Zyrës Rajonale të INSTAT-it, operacioni i mbledhjes së të dhënave në terren do të realizohet në secilën bashki nga një ekip i zyrës së bashkisë duke përfshirë personelin e mëposhtëm:

- Një udhëheqës i Zyrës Bashkiake përgjegjëse për menaxhimin e ekipit, të zgjedhur midis mbikëqyrësve. Në bashki të mëdha (të tilla si Tirana, Durrësi, Elbasani dhe Shkodra) mund të krijohet më shumë se një zyrë bashkiake.
- Mbikëqyrësit përgjegjës për trajnimin e anketuesve dhe kontrollorëve, si dhe të menaxhimit administrativ dhe teknik të cens në zonën e caktuar në Bashki. Në varësi të madhësisë së Bashkisë, do të ketë një ose më shumë mbikëqyrës.
- Staf Mbështetës të Teknologjisë së Informacionit (SMTI) që janë përgjegjës për funksionimin e duhur të tabletave në terren. Ata do të kujdesen për mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike të përdorura në terren dhe në Zyrat e Censit (Qendrore, Rajonale, Vendor) dhe do të garantojnë disponueshmërinë e përhershme të rrjeteve kompjuterike për të lehtësuar transferimin e të dhënave.
- Staf Mbështetës të GIS (GSO), të ngarkuar me mbështetjen e anketuesve dhe kontrollorëve në terren për t'u marrë me çështjet hartografike, për shembull për të marrë të dhëna GPS për të gjeokoduar të dhënat e cens;
- Kontrollorët përgjegjës për kontrollin e cilësisë së punës së bërë nga anketuesit. Këta kontrollorë do të veprojnë si lidhje ndërmjet anketuesve dhe mbikëqyrësve. Anketuesit përgjegjës për numërimin në zonat e caktuara të cens, kryerjen e intervistave me njësitë ekonomike familjare dhe / ose institucionet dhe regjistrimin e informacionit të mbledhur në tableta, sipas manualeve të udhëzimeve.

Tabela 2: Numri i stafit në terren gjatë fazës së mbledhjes së të dhënave

Kategoritë e stafit në terren	Numri i stafit në terren
Mbikëqyrës	234

Oficerët mbështetës IT	201
Oficerët mbështetës GIS	100
Kontrollorë	1200
Anketues	6000

8.1.3 Komisionet bashkiake

Komisionet Bashkiake janë struktura të rëndësishme, pasi ata do të mbështesin INSTAT-in në zbatimin e operacionit të cens në nivel bashkiak. Detyrat kryesore të tyre janë të motivojnë popullsinë dhe të sigurojnë funksionimin e qetë të operacioneve në territorin e tyre përkatës. Anëtarët e tyre janë kryesisht autoritetet politike, administrative, civile dhe fetare, duke përfshirë grupet dhe OJQ-të që merren me çështje gjinore.

Funksionet kryesore të Komisioneve Bashkiake përfshijnë:

- Mbështetjen e INSTAT-it në organizimin dhe manaxhimin e punës përgatitore të censit në zonat e regjistrimit brenda territorit të bashkive;
- Mobilizimin e palëve të interesuara dhe personalitetet në bashkitë për të mbështetur cens dhe për të ndihmuar INSTAT në fushatën e komunikimit dhe publicitetit në nivel lokal;
- Sigurimin e hapësirave të nevojshme për të lehtësuar trajnimin e stafit të terrenit brenda bashkisë.

8.1.4 Komunikimi në terren

Kontakti dhe komunikimi përbëjnë aspekte kryesore të operacionit të Censit, pasi ato mundësojnë shkëmbimin e shpejtë të informacionit, duke lejuar Njësinë e Censit të INSTAT të planifikojë më mirë realizimin e aktiviteteve, të informohet menjëherë për problemet që mund të ngrihen në vende të ndryshme të territorit dhe të sjelli zgjidhjet e nevojshme sa më shpejt të jetë e mundur.

Ndarja e informacionit ose transmetimi i urdhrave do të bëhet në formë kaskadë në mënyrë të tillë që Drejtuesi i Projektit të jetë në kontakt të drejtpërdrejtë me Drejtuesin e Zyrës Rajonale i cili, nga ana e tij do të transmetojnë udhëzime tek Zyrat Bashkiake dhe mbikqyrësve nga ku, udhëzimet do të shkojnë tek kontrollorët dhe anketuesit.

8.1.5 Numrat dhe shpërndarja e stafit anketues

Mbledhja e të dhënave të Censit 2011 është kryer gjatë 3 javëve, zgjatet deri në 4 javë në disa vende, nga 11,906 anketues, 2,330 kontrollues dhe 128 supervizor. Për Censin, është planifikuar të zgjatet periudha e mbledhjes së të dhënave deri në gjashtë javë duke përgjysmuar numrin e stafit të terrenit. Kjo, jo vetëm që do të zvogëlojë numrin dhe koston e tabletave, por gjithashtu do të mundësojë një rekrutim më selektiv (shih kapitullin 11 mbi procesin e rekrutimit). Tabela 3 e mëposhtme paraqet numrat e planifikuar dhe shpërndarjen e stafit në terren për bashki.

Tabela 3: Numri i numëruesve sipas bashkive

Municipality	Municipal super- visors	Controllers	Enum- rators	Municipality	Municipal super- visor	Controllers	Enum- rators
Berat	5	26	129	Dropull	1	2	8
Ura Vajgurore	3	12	58	Korçë	6	33	163
Kuçovë	3	13	67	Pogradec	5	26	132
Skrapar	2	5	27	Maliq	4	18	89
Polican	2	5	23	Pustec	1	1	7
Dibër	5	26	132	Kolonjë	2	5	24
Bulqizë	3	13	67	Devoll	3	11	57
Mat	3	12	59	Kukës	4	21	103
Klos	2	7	36	Tropojë	2	9	44
Durrës	12	75	375	Has	2	7	36
Shijak	3	12	60	Lezhë	5	28	141
Krujë	5	26	128	Mirditë	2	9	47
Elbasan	10	61	304	Kurbin	4	20	99
Cërrik	3	12	59	Shkodër	9	58	291
Belsh	2	8	42	Vau i Dejës	3	13	65
Peqin	3	11	56	Malësi E Madhe	3	13	66
Gramsh	2	10	52	Pukë	2	5	24
Librazhd	3	14	68	Fushë Arrës	1	3	16
Prenjas	3	11	53	Tiranë	35	239	1194
Fier	8	52	259	Kamëz	7	45	223
Lushnje	6	36	179	Vorë	3	11	55
Patos	2	10	49	Kavajë	3	17	86
Roskovec	2	9	47	Rrogozhinë	2	9	47
Divjakë	3	15	73	Vlorë	7	45	225
Mallakastër	3	12	58	Himarë	1	3	17
Gjirokastrë	3	12	61	Sarandë	2	10	50
Libohovë	1	2	8	Konispol	2	4	18
Përmet	2	5	23	Delvinë	1	3	17
Këlcyrë	1	3	13	Finiq	1	3	16
Tepelenë	2	4	19	Selenicë	2	7	35
Memaliaj	2	5	23	Total	234	1200	6000

8.2 Trajnimi

8.2.1 Strategjia e trajnimit

Qëllimi i trajnimit është që të arrihet një mirëkuptim i përbashkët midis stafit mbi përmbajtjen, fazave dhe organizimit të projektit të censit dhe të prezantoj dhe mbikëqyrë udhëzimet teknike në nivele të ndryshme të ndërveprimit për të siguruar cilësinë dhe homogjenitetin e numërimit. Trajnimi do të organizohet kryesisht si trajnim i trajnerëve në nivele të ndryshme.

Për rezultatet e regjistrimit cilësor, është thelbësore që personeli në terren i regjistrimit të marrë trajnim me cilësi të lartë.

Një qasje trajnimi hierarkike (kaskadë) përmban rreziqe të larta të mesazheve jokonsistente në të gjithë vendin dhe humbjes së informacionit dhe futjes së gabimeve në secilin nivel zbritës të trajnimit.

Në këtë qasje, shumica e personave që do të trajnojnë anketuesit e anketës nuk kanë më shumë njohuri dhe përvojë në marrjen e anketimit sesa anketuesit që ata trajnojnë. Për të siguruar mesazhe plotësisht të qëndrueshme dhe pa gabime në trajnimin e stafit të anketimit, ekspertët kryesorë përgjegjës të njësive përkatëse të anketimit të INSTAT - Metodologjia, IT, GIS, Logjistika, Burimet Njerëzore - do të prodhojnë seanca trajnimi të regjistruara me video në lidhje me përmbajtjen, operacionet, procedurat, detyrat dhe përgjegjësitë. Kjo video do të përbëjë thelbin e trajnimeve të stafit të Selisë Qendrore të INSTAT, stafit të Zyrës Rajonale, stafit të Zyrës Bashkiake, mbikëqyrësve, kontrollorëve dhe anketuesve. Për më tepër, personeli i Zyrave Qendrore të INSTAT dhe personeli i Zyrës Rajonale do të trajnohen në trajnimin e stafit të Zyrës Bashkiake dhe mbikëqyrësit për mbikëqyrjen e trajnimeve të kontrolluesve dhe anketuesve, kryerjen e ushtrimeve dhe testeve në këtë trajnim.

Trajnimi i mbikëqyrësve, kontrollorëve dhe anketuesve do të ketë secili kohëzgjatje prej pesë ditësh. Numri i kursantëve për seancë do të jetë ndërmjet 15 dhe 20 pjesëmarrës për të siguruar pjesëmarrje aktive. Stafi i regjistrimit të INSTA do të marrë pjesë sa më shumë të jetë e mundur në seancat e trajnimit për të monitoruar trajnimin dhe për të vepruar si persona burim. Tabletat do të përdoren për aplikime të e-mësimit, ushtrime praktike dhe teste. Rezultatet e këtyre testeve do të përbëjnë thelbin e procedurës përfundimtare të përzgjedhjes së stafit në terren. Kursantët që nuk zgjidhen do të mbahen në një grup të stafit rezervë.

Trajnimi i Stafit të Mbështetjes së TI-së dhe të GIS-it do të kryhet nga stafi përkatës i Njesisë së IT-së dhe GIS-it të INSTAT.

Do të organizohet një trajnim fillestar për komunikim të brendshëm për ekipin e censit dhe një trajnim për gazetarët që mbulojnë ngjarjet shoqërore (pjesë e planit PR).

Trajnimi i stafit të terrenit do të përqendrohet kryesisht në kuptimin e procedurave të Censit, administrimin e pyetësorëve, intervistave të njësive të banimit, përdorimin e tabletave dhe proceset e transmetimit dhe raportimit. Trajnimet do të përdorin manualët e udhëzimeve si bazë, për stafin që të kuptojë plotësisht metodat e regjistrimit dhe mjetet teknike që do të përdorin.

8.2.2 Ambientet e trajnimit

Ambientet e trajnimit, për trajnimin e supervisorëve do të identifikohen nga Zyrat Rajonale Statistike së bashku me punonjësin e logjistikës (në nivel Qarku) që mbulon atë zyrë. Informacionin e nevojshëm mbi: numrin e bashkive në nivel Qarku, numrin e supervisorëve të planifikuar, numrin e ambjenteve të nevojshme për trajnimin e supervisorëve në nivel Qarku, distancat e Bashkive nga qendra e trajnimit, kushtet për ambjentet e trajnimit, pajisjet/aksesor për trajnimin, do të mblidhen nga terreni nëpërmjet një formulari (nese do jetë e nevojshme marrja e zyrave me qera) dhe do të dorëzohen në Njësinë e Prokurimit të Cens.

Në secilën bashki, Zyra Bashkiake, me mbështetjen e Komisionit Bashkiak të Censit, duhet të identifikojë paraprakisht ambjentet e mundshme për trajnim. Ndërtesat e zgjedhura mund të jenë shkolla publike ose private, apo ndërtesa të tjera publike që plotësojnë standardet e sigurisë dhe kanë hapsirat e nevojshme për sesionet e trajnimit. Vëmendje do t'i kushtohet disponueshmërisë së pajisjeve të projektimit dhe të furnizimit me energji elektrike.

8.2.3 Kurrikulumi dhe mjetet e trajnim

Pavarësisht nga kategoria e stafit, trajnimet do të mbulojnë:

- Censi, përkufizimin dhe rëndësinë e tij, strukturën organizative, procesin e hartografisë, mjetet dhe instrumentet e regjistrimit (hartat, pyetësorët, formatet, tabletat, manualët), teknikat e supervizimit, parimet e konfidencialitetit etj;
- Komunikimin me autoritetet, të anketuarit dhe supervisorët;
- Përgjegjësitë e stafit të censit, duke u bazuar në elemente të tilla si besueshmëria, udhëheqja, ndjenja e vendimmarrjes, respektimi i konfidencialitetit etj;
- Manaxhimin e materialeve (transporti, transmetimi i të dhënave, rikuperimi, riparimi etj.);
- Procedurat administrative dhe financiare, raportimi, kontrolli dhe supervizimi etj.
- Manaxhimin e stafit (shpërndarja në terren, komunikimi, raportimi, supervizimi etj.);

8.3 Puna në terren për censin

8.3.1 Detyrat e anketuesve

Censi në terren pritët të realizohet për 6 javë. Detyrat kryesore të anketuesve janë:

- Të identifikojnë, me ndihmën e kontrollorit, kufijtë e saktë të qendrës së caktuar të regjistrimit (QR);
- Identifikojnë, nga harta në tabelë, të gjitha ndërtesat brenda ZC-së të caktuar;
- Numërojnë të gjithë personat rezidentë në banesat ose njesive të tjera të banimit ZC- të caktuar;
- Intervistojnë anëtarët e njesivebanimi ose banesave kolektive në institucione në bazë të udhëzimeve;
- Plotësojnë pyetësorët në tabletë sipas udhëzimeve;
- Kontrollon pyetësorët pas çdo interviste;
- Informojnë rregullisht kontrollorin për pyetësorët e plotësuar;
- Sigurohen që të dhënat e mbledhura të transmetohen (kjo duhet të bëhet automatikisht nga aplikacioni);
- Përgatisin një raport në fund të numërimit duke iu përgjigjur një pyetësori në tabelë;
- Ruajnë dhe sigurojnë pajisjet dhe materialet e disponueshme dhe t'i kthejnë në fund të punës në terren.

Anketues të posaçëm do të caktohen për të numëruar personat që jetojnë në banesa kolektive dhe personat e pastrehë, duke përdorur një version të reduktuar të kuotës së shtëpisë private. Do të bëhet një inventar para regjistrimit për të gjetur vendbanimet kolektive dhe personat e pastrehë dhe do të zhvillohen procedura të përshtatura për numërimin e këtyre grupeve të popullsisë.

8.3.2 Kontrolli dhe mbikëqyrja

Kontrolli i procesit të regjistrimit dhe përputhshmëria me udhëzimet është thelbësore për të siguruar mbulimin dhe cilësinë e të dhënave gjatë censit. Kontrolli dhe supervizimi i punës në terren do bëhet në katër nivele.

Niveli i parë i është besuar kontrollorit. Çdo bashki do të ndahet në zonat e anketuesit dhe zonat e kontrollit. Zonat e kontrollit vendosen nën përgjegjësinë e një kontrollori dhe riorganizojnë

katër deri pesë zona të numërimit, bazuar në afërsinë e tyre dhe në madhësinë e popullsisë së tyre. Kontrollorët do të përdorin një aplikacion në tabletën e tyre për të kontrolluar të dhënat e mbledhura nga anketuesit nën përgjegjësinë e tyre. Ky aplikacion do të përfshijë kontrolle dhe paralajmërime specifike, bazuar në treguesit që lidhen me të dhënat e mbledhura (siç janë madhësia e njësi-banimit, strukturën e moshës dhe gjinisë, si dhe variabla të tjerë kritikë). Gjithashtu aplikacioni do të nxjerrë një kampion të njësi-banimit që do të rishikohen nga kontrollori, për të verifikuar që anketuesi në mënyrë efektive ka intervistuar këtë njësi-banimit. Niveli i dytë i supervizimit është nën përgjegjësinë e supervizorit, i ngarkuar me detyrat e mëposhtme:

- Koordinon aktivitetet e mbledhjes së të dhënave në Bashki ose pjesë të Bashkisë;
- Kontrollon dhe mbikëqyr punën e kontrollorëve dhe anketuesve;
- Sigurohet që të gjitha zonat e cens nën përgjegjësinë e tij /saj janë numëruar.

Supervizori përmes një kampioni, do të kontrollojnë cilësinë e pyetësorëve të transmetuar nga kontrollorët, për të siguruar që pyetësorët përmbushin standardet e cilësisë.

Niveli i tretë i supervizimit sigurohet nga Zyra Rajonale, e cila do të kryejë detyrat e mëposhtme:

- Organizon dhe monitoron operacionet e mbledhjes së të dhënave në rajon;
- Kontrollon punën e Zyrave Bashkiake dhe supervizorëve në Rajon;
- Sigurohun që i gjithë Rajoni të jetë plotësisht i mbuluar nga regjistrimi.

Niveli i katërt i supervizimit përfshin teknikët dhe drejtuesit e Njesisë së Censit që do të caktohen ekskluzivisht në mbikëqyrjen e punës në terren dhe do të paraqesin raporte të rregullta të progresit për informim dhe vendimmarrje.

Një aplikacion në web do të jetë në dispozicion për të aksesuar të dhënat e zonave përkatëse të supervizorëve, nga ku teknikët e Njesisë Qendrore të Censit do të jenë në gjendje të kontrollojnë këto të dhënat të transmetuara nga terreni sapo të futen në bazën qendrore të të dhënave. Indikatorë të veçantë do të zhvillohen për të vlerësuar cilësinë e të dhënave, me mundësinë që Njësia e Censit të kontrollojë direkt bazën e të dhënave për vleresime të mëtejshme.

8.3.4 Monitorimi i progresit

Një aplikacion i veçantë web do të zhvillohet për të siguruar monitorimin e progresit të regjistrimit në terren. Ky aplikacion, i lidhur me bazën qendrore të të dhënave, do të lejojë aksesin tek numri i pyetësorëve të plotësuar sipas fushave. Aplikacioni do të jetë i disponueshëm për Zyrat Bashkiake dhe Rajonale për zonat e tyre të përgjegjësisë dhe natyrisht për selinë e INSTAT-it.

Tabelat standarde do të paraqesin progresin e numërimit dhe do të krahasohen me numrin e pritshëm të ndërtesave dhe banesave të identifikuara gjatë fazës së përditësimit të hartave për të ndjekur shkallën e përfundimit. Kjo do të lejojë monitorimin rigoroz të progresit të numërimit të cens dhe krahasimet ndërmjet zonave në të gjithë territorin.

8.3.5 Vlefshmëria e të dhënave të mbledhura

Vlefshmëria e të dhënave të mbledhura do të bëhet në nivele të ndryshme të strukturës në terren. Në nivelin e parë, kontrollorët verifikojnë pyetësorët e anketuesve të tyre, duke zbatuar udhëzimet e manualeve të anketuesve dhe kontrollorëve dhe duke përdorur aplikacionin e kontrollorit në tabletën e tyre. Ata garantojnë cilësinë e punës së bërë nga secili prej anketuesve të tyre. Pasi gjykojnë se të dhënat janë të sakta, ato i vlerësojnë pyetësorët përkatës përmes aplikacionit dhe shënojnë si "të vlefshëm" ato të dhëna në bazën qendrore të të dhënave. Ky vleftësim i kontrollorit mund të anulohet nga supervizori ose stafi i zyrave qendrore të INSTAT në rast se ata gjejnë anomali gjatë procesit të kontrollit të tyre.

9. Teknologjia e informacionit dhe përpunimi i të dhënave

9.1 Historik

Përparimet e shpejta në teknologjitë së informacionit dhe komunikimit po transformojnë mënyrën e mbledhjes së të dhënave, dhe veçanërisht të dhënave të censuseve, në terren. Zhvillimet e fundit, veçanërisht në pajisjet elektronike të lëvizshme dhe telefonisë celulare, kanë mundësuar qasje inovative për mbledhjen e të dhënave në një mënyrë më të shpejtë dhe me cilësi më të lartë, duke ofruar potencial të madh në integrimin e këtyre metodave të reja për të përforcuar programet statistikore të INSTAT në mbledhjen e të dhënave. Pajisjet e lëvizshmeës, të tilla si tableta, celular smart dhe laptopë, kanë treguar potencial të lartë në përmirësimin e cilësisë së të dhënave dhe në shkurtimin e kohës së mbledhjes së të dhënave. Këto mjete po konsiderohen standard në mbledhjen e të dhënave në terren.

Kalimi nga mënyra tradicionale e intervistimit me letër dhe laps (PAPI) në Intervistimin personale me ndihmën e kompjuterit (CAPI) ka të bëjë me përdorimin e pyetësorëve elektronikë që administrohen përmes pajisjeve elektronike të lëvizshme, gjatë kryerjes së intervistave ballë për ballë. Kjo mënyrë intervistimi, sjell avatazhe dhe përparësi në drejtim të eficiencës, efektivitetit dhe cilësisë së të dhënave. Krahasuar me mënyrën tradicional të intervistimit që përfshin një fazë të centralizuar të mbledhjes së të dhënave, përdorimi i pajisjeve elektronike të dorës ofron digjitalizim të menjëhershëm të të dhënave në momentin e mbledhjes së tyre. Kjo mundëson përpunimin më të shpejtë dhe të automatizuar të të dhënave.

Megjithatë, përdorimi i CAPI ka një ndikim në të gjithë procesin e censit, implementimi i tij vjen me sfida të ndryshme në operacionet e censit. Avantazhet e përdorimit të suksesshme të CAPI-it në cens nuk mund të realizohen pa një angazhim të fortë të INSTAT, për të kaluar në mënyrë taktike dhe strategjike drejt sistemeve të reja teknologjike. Vendimi për të përdorur CAPI në vend të PAPI është i rëndësishëm dhe duhet të bëhet në fazat fillestare të planifikimit të censit, me njohuri të sakta të teknologjive të reja dhe vlerësimin e mjedisit operativ në termat e kapacitetit institucional, infrastrukturës dhe terrenit.

9.2 Fizibiliteti i mbledhjes së të dhënave me CAPI


Përshtatja e mbledhjeje të të dhënave të bazuara në CAPI kërkon planifikim të kujdesshëm. Suksesi i çdo lloj metode elektronike të mbledhjes së të dhënave varet nga strategjia plani operacional dhe manaxhimit si dhe nga infrastruktura institucionale. Për të siguruar suksesin e Cens-it, është thelbësore të indentifikohen të gjitha nevojat për përdorimin e teknologjisë elektronike në mbledhjen e të dhënave, dhe të hartohen planet e punës për këtë qëllim që në fazat e para të jetës së projektit. Planifikimi duhet të marrë në konsiderat disa faktorë kritikë.

9.2.1 Konsideratat e infrastrukturës

Shqipëria dhe vendet e tjera të Ballkanit duke përfshirë Serbinë, Bullgarinë dhe Kroacinë kishin çuditërisht cilësi të lartë pavarësisht nga infrastruktura e ulët elektronike.

Rrjeti celular i Shqipërisë përbëhet nga 86.3% e kullave që mbështesin 3G/4G dhe vetëm 13.7% që mbështesin 2G (<https://www.cellmapper.net/networks?country=276&net=ALL>). Për sa i përket pikave të të dhënave kjo do të thotë se 95.2% e tyre mbështesin 3G/4G. Harta e mëposhtme (<https://opensignal.com/>) tregon mbulimin e rrjetit celular 2G/3G dhe 4G për të gjithë territorin e Shqipërisë. Pikat në të gjelbër tregojnë një sinjal të fortë ndërsa lëvizin drejt të kuqes, sinjali i të dhënave bëhet më i dobët.

Figura 4: Fuqia e sinjalit të rrjetit celular në Shqipëri



Pjesa më e madhe e vendit është e mbuluar mirë me një sinjal të kënaqshëm. Për më tepër, një analizë e hollësishme e zonave që nuk mbulohen nga rrjeti celular tregon se këto janë kryesisht zona malore pa ose me një numër shumë të kufizuar të banorëve. Mbulimi i rrjetit celular 4G në Shqipëri është shumë më i kufizuar dhe i kufizuar kryesisht në qytetet kryesore (Tirana, Shkoder, Shëngjin, Krujë, Durrës, Elbasan, Fier, Berat, Vlorë, Sarandë). Popullsia e mundshme e mbuluar nga rrjeti shqiptar vlerësohet në 99.8% (https://www.theglobaleconomy.com/Albania/Mobile_network_coverage/).


Indeksi Global i Speedtest (<http://www.speedtest.net/global-index>) krahason të dhënat e shpejtësisë së internetit nga e gjithë bota çdo muaj. Shpejtësia e përgjithshme e një vendi përcaktohet si lidhja mesatare e të dhënave celulare që një përdorues përjeton bazuar në shpejtësitë dhe disponueshmërinë e rrjeteve 2G/3G dhe 4G të një vendi.

Duke marrë parasysh të gjitha vendet e shqyrtuara nga Indeksi Global i Speedtest në Janar 2018, shpejtësia mesatare e përgjithshme e brezit të gjerë celular në të gjithë vendet është 34.5 Mbps në Shkarkim dhe 10.9 Mbps në Ngarkim. Shqipëria renditet në 23 mbi 123 vende, menjëherë pas Tajvanit dhe para Suedisë, SH.B.A., Franca dhe Gjermania. Shpejtësia e përgjithshme e lëvizshme shqiptare vlerësohet në 50.6 Mbps në Shkarkim dhe 37.1 Mbps në Ngarkim.

Më 30 qershor 2019, Përdoruesit e Internetit në Shqipëri janë 2,160,000 mbi një popullsi të vlerësuar prej 2,938,428 (<https://www.internetworldstats.com/stats4.htm>). Kjo sjell një shkallë të depërtimit në internet prej 73.5%, krahasuar me një normë mesatare prej 87.7% për të gjithë Evropën.

Raporti më i fundit i OpenSignal mbi situatën globale të rrjeteve mobile (<https://opensignal.com/reports/2017/02/global-state-of-the-mobile-network>) zbuloi se përdorimi i Wi-Fi në Shqipëri ishte në rënie gjatë viteve të fundit. Harta e mëposhtme tregon se Shqipëria është një nga vendet në rajon me shkallën më të ulët (38.6%) të kohës së internetit të shpenzuar në Wi-Fi.

Figura 5: Koha e shpenzuar në internetit me Wi-Fi në Shqipëri dhe në vendet fqinje



Analiza e rrjetit të telefonisë celulare dhe fikse në Shqipëri nënvizon mundësinë e adaptimit të mbledhjes së të dhënave të cens në mënyrë elektronike. Ajo gjithashtu thekson

avantazhet e përdorimit të rrjetit celular (2G/3G, 4G) sesa lidhja e të dhënave në krahasim me Wi-Fi si mjet standard për transmetimin e të dhënave. Sidoqoftë, duhet të zhvillohen plane rezervë për karikimin dhe mbështetjen e pajisjeve për rastet kur nuk ka energji elektrike dhe /ose internet. Së fundi, shkalla e depërtimit të internetit në Shqipërisë, së bashku me rritjen e kohës së shpenzuar për broadbandin celular, vlerësohet të jetë e mjaftueshme për të siguruar rekrutimin e personelit në terren që janë të njohur me parimet e funksionimit të pajisjeve të lëvizshme.

9.2.2 Parashikime buxhetore

Adoptimi i çdo teknologjie inovative paraqet sfida dhe duhen të marrë në konsideratë vetëm pas vlerësimit të kostove dhe përfitimeve. Tabela e mëposhtme tregon shpenzimet e llogaritura të kryerjes së Censit me metodën PAPI (duke përdorur teknologjinë e skanimit), bazuar në koston e Censusit 2011, e krahasuar me kostot sipas metodës CAPI.

Tabela e mëposhtme tregon vetëm elementet e buxhetit që afektohen nga përdorimi i metodës PAPI dhe CAPI të mbledhjes së të dhënave. Supozohet se kostoja e përgjithshme e fuqisë punëtore që nevojitet në terren (pagat e anketuesve, kontrollorëve etj.) është e njëjtë në të dyja rastet, sepse reduktimi me gjysmën e numrit të numëruesve në censin me metodën CAPI kompensohet nga dyfishimi në madhësi të ZC-it që do të mbulohen dhe kohëzgjatja e punës në terren. Por reduktimi i numrit të anketuesve ka një ndikim të madh në koston e pajisjeve, sepse vetëm për anketuesit duhet të prokurohen 6000 tableta.

Në tabelë e mëposhtme tregohen me ngjyrë të kuqe zërat ku rriten kostot nga PAPI në CAPI, ndërsa zërat ku ulen kostot shënohen me ngjyrë blu.

Tabela 4: Kosto e përlllogaritur e TI-së, nevojat e trajnimit, materialet dhe pajisjet në një census PAPI dhe CAPI

Zërat		Metoda mbledhjes së të dhënave	
		PAPI me skanim	CAPI
	Kosto fikse		
1	Pajisje hardware	751'942	2'358'150
2	Software	421'792	514'482
3	Pajisje të tjera elektronike	60'155	87'000
4	Tarifat e mirëmbajtjes	16'241	48'903
	Kosto variabël		
5	Asistencë teknike, trajnime dhe vizitat studimore	2'564'883	3'077'860
6	Printimi i pyetësori dhe materialet e terrenit (vetëm PAPI)	587'667	-
7	Transporti i materialeve dhe Arshivimi	731'239	64'600
8	Tarifat e transferimi të të dhënave (vetëm CAPI)		218'000
9	Skanimi dhe verifikimi (vetëm PAPI)	883'340	
	Kosto totale	6'017'259	6'368'995

Siç mund të vërehet, kostot e përgjithshme janë të një madhësie të ngjashme në dy metodat e mbledhjes së të dhënave. Kostot për CAPI janë pak më të larta, e cila është kryesisht për shkak të kostove të hardware, që shkon nga 751,942 në 2,358,150 euro. Kjo kosto përfshin investime për rreth 8.500 tableta (duke përfshirë 12% rezervë), 300 laptopë, 1 server të dedikuar dhe 1 server rezervë. Këto investime janë qartësisht më të qëndrueshme se kostot për letër, transport, arkivim dhe skanim në censin me metodën PAPI, të cilat nuk mund të ri-përdoren.

Pika 5 (Asistenca teknike, trajnimet dhe vizitat studimore) rritet me rreth 20% për shkak të natyrës shumë teknike të mbledhjes së të dhënave digjitale dhe zhvillimit të aplikacioneve të nevojshëm. Në të vërtetë, duhet t'i kushtohet vëmendje e duhur aftësive teknike dhe llojit të ekspertizës së nevojshme për ndërtimin e kapaciteteve të stafit të INSTAT-it. Asistenca Teknike është vendimtare në ofrimin e njohurive për zhvillimin dhe testimin e aplikacioneve, ngritjen e sistemit të transferimit të të dhënave dhe testimin e pajisjeve kompjuterike të lëvizshme.

Nga ana tjetër, përdorimi i pyetësorit elektronik pothuajse eliminon shpenzimet për printimin e pyetësorëve në letër (pika 6), transportin dhe arshivimin e materialeve (pika 7), si dhe për skanimin dhe verifikimin (pika 9). Pika 8 (tarifat e transferimit të të dhënave) është e nevojshme vetëm për metodën CAPI dhe përfshin koston e kartave SIM, për të përdorur rrjetin celular nga tabletat dhe rrjetin e dedikuar të internetit për zyrën qendrore të INSTAT me një gjerësi rrjeti 1 Gbit/sec

9.2.3 Përfitimet dhe risqet e CAPI kundrejt PAPI

CAPI ndryshon natyrën e mbledhjes së të dhënave dhe shkon drejt investime që janë më të qëndrueshme se metoda PAPI. Përfitimet e pritshme (paraqiten në ngjyrë blu) krahasuar me risqet (paraqiten në ngjyrë të kuqe) të adoptimit të mbledhjes së të dhënave me metodën CAPI janë veçanërisht të rëndësishme për efikasitetin e analizimit të të dhënave, siç tregohet në tabelën e mëposhtme (PAPI bazuar në përvojën e Censit 2011). Metoda CAPI krijon në anën tjetër risqe të reja të cilat duhet zvogëluar (paraqitur në ngjyrë të kuqe).

Tabela 5: Përfitimet dhe risku: PAPI me skan dhe CAPI

Njësitë	PAPI me Skan (2011)	CAPI
Vlefshmëria e menjëhershme e ndërlidhjes me të dhëna të tjera	I ulët	I lartë
Modele automatike sekuenciale për anashkalimin e pyetjeve	I ulët	I lartë
Kontrollet e konsistencës	-	I lartë
Materiale udhëzuese dhe ndihmuese të integruar	I ulët	I lartë
Transmetimi i shpejtë i të dhënave në serverat qendror	-	I lartë

Prodhimi i menjëhershëm i metrikës vlerësuese të performancës të veprimeve në terren dhe raportimi përmbledhës i njësive të numëruara	I ulët	I lartë
Aftësia për të siguruar cilësinë e kufijve gjeografikë	I ulët	I lartë
Mundësia për të kaluar midis pyetësorëve në gjuhë të ndryshme	I ulët	I lartë
Mospërputhshmëria midis hardware dhe / ose softwarit	I mundshëm	I mundshëm
Moszgjidhja e problemit (mungesa e lidhjes, dështimi i hardware, bateri, problematikat e GPS, viruset e software, vjedhja e pajisjeve)	Zbatohet në një masë të caktuar	Ndodh/s hfaqet deri në një fare mase
Mungesa e aftësive ose njohurive nga përdoruesit e sistemit, veçanërisht stafi i i terrenit të cens	I ulët	Më i lartë
Hakimi, sulme në internet ose çështje të tjera të sigurisë IC	Më I ulët	Më i lartë

Risqet e renditura në fund të tabelës mund të zvogëlohen në disa mënyra. Për sa i përket papajtueshmërisë midis hardware dhe/ose software, risku mund të zvogëlohet përmes përgatitjes së saktë të specifikimeve teknike dhe përmes testeve të paisjeve.

Risku i dështimit në zgjidhjen e problematikave duhet të zbutet duke përdorur mënyra alternative për transmetimin e të dhënave (Wi-Fi), me bateri të jashtme shtesë, zëvendësimin e pajisjeve të vjedhura ose dëmtuara etj. Mungesa e aftësive ose njohurive nga përdoruesit e sistemit duhet të zvogëlohen duke zhvilluar një aplikacioni të thjeshtë në përdorim me ndihmë të inkuorporuar në paisje, trajnime dhe mbështetje përmes stafit të TI në terren.

Risku i sulmeve online dhe çështje të tjera të sigurisë duhet të zvogëlohen duke siguruar që të dhënat e mbledhura të jenë të koduara dhe secili përdorues të ketë llogarinë e vet në bazën qendrore të të dhënave, e cila mundësohet përmes kredencialeve të njohura vetëm nga aplikacioni dhe jo nga përdoruesi. Për të përforcuar sigurinë do të përdoren serverera të dedikuara përgjatë gjithë operacionit. Përfitime të tjera të rëndësishme për metodën CAPI) konsiderohen edhe pikat e paraqitura me ngjyrë blu në tabelën e mëposhtme:

Tabela 6: Përfitime të tjera të CAPI kundrejt PAPI

Njësitë	PAPI me skan (2011)	CAPI
Hapësira për grumbullimin dhe rruajtjen e dhënave	Hapësira e madhe e kërkuar për ruajtjen e pyetësorëve me kohëzgjatje të gjatë të ruajtjes	Efiçiente – kërkon hapësirë minimale
Qasja për transport e materialeve dhe pajisjet	Ka rezultuar e vështirë vitin 2011	Pajisjet mund të shpërndahen dhe grumbullohen lehtësisht
Siguria fizike për magazinim	Nuk është e lehtë për të manaxhuar, veçanërisht pas mbledhjes së të dhënave	Pajisjet mund të bëhen të gjurmueshme
Koha e parashikuar për rikthimin e mbledhjes së të dhënave	1 muaj	Afati i kthimi i të dhënave të papërpunuara në selinë qendrore është 1 javë
Koha e parashikuar për tabulimet e para pas mbledhjes dhe skanimit të të dhënave	7 muaj	2 muaj
Cilësia e të dhënave të mbledhura (ceteris paribus)	I pranueshëm	E mirë
Kërkesat e fuqisë punëtore	Fazat e rëndësishme të punës fizike: paketimi, ngarkimi dhe shkarkimi i materialeve	Më shumë kohë për punë teknike

Kjo analizë e përmbledhur kosto-përfitim tregon se edhe pse buxheti për CAPI është pak më i lartë sesa për PAPI, metoda CAPI ka shumë përfitime që rrjedhin nga teknologjia dhe investimet e lidhura me të.

9.2.4 Gatishmëria institucionale

Gatishmëria institucionale i referohet aftësisë së INSTAT-it për të adoptuar mbledhjen elektronike të të dhënave dhe për ta zbatuar atë në menyrë strategjike. Duhet pasur parasysh që investimet e nevojshme për mbledhjen elektronike të të dhënave ndryshojnë në varësi të kapacitetit ekzistues të INSTAT-it, duke përfshirë eksperiencën e përdorimit të e këtyre teknologjive në fusha të tjera statistikore.

Gjatë viteve të fundit INSTAT ka përdorur mbledhjen elektronike të të dhënave me CAPI në disa anketa. Së fundmi, janë kryer disa anketa duke përdorur mbledhjen elektronike të të dhënave si: Anketa e Forcave të Punës (AFP), Anketa e Demografisë dhe Shëndetit, Anketa e Migracionit dhe Kthimit, Anketa e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, dhe dy anketa për Bankën e Shqipërisë (Anketa e Besimit të Ndërmarrjeve, dhe Anketa e Besimit të Konsumatorit). AFP kryhet rregullisht duke përdorur laptopë windows, edhe për anketat e tjera janë përdorur gjithashtu laptopë windows e ndërsa vërtetimit për Bankën e

Shqipërisë u krye me tableta Android. Në të dy rastet zhvillimi i CAPI është bërë nga INSTAT, me asistencë teknike të ofruar nga donatorë të ndryshëm.

Aktualisht, INSTAT ka njohuri dhe eksperiencë në zhvillimin dhe testimin e aplikacioneve CAPI, por nuk janë të mjaftueshme për të zhvilluar dhe implementuar në mënyrë të plotë censin 2021 nga vetëm burimet të brendshme të INSTAT. Për më tepër, njësia e TI e INSTAT-it është duke u zhvilluar dhe nuk ka personel mjaftueshëm. Duhet të punësohen staf TI të përkohshëm dhe ofrohet asistencë teknike për zhvillimin dhe testimin e platformës CAPI për censin si dhe transmetimin know-how të njohurive për stafin e TI. Për këto arsye në projektin cens janë planifikuar trajnime, workshop-e dhe vizita studimore.

9.2.5 Kalendar i cens

Planifikimi i cens duhet ti përshtatet nevojave të implementimit të mbledhjes së të dhënave me pajisje elektronike të lëvizshme. Me mbledhjen e të dhënave me metodën CAPI, mund të integrohen procese që më parë ishin të ndara, ose mund të kryhen në fazat më të hershme të censit. Për shembull, mbledhja, dhe editimi i të dhënave mund të bëhet njëkohësisht me adaptimin e një zgjidhjeje CAPI. Megjithatë, në përgjithësi, nevojitet më shumë kohë për të zhvilluar dhe testuar aplikacionin, përgatitjen e kodeve dhe rregullave të validimit, ngritjen e sistemeve për transferimin dhe analizimin e të dhënave, prokurimin, programimin dhe testimin e tabletave. Rrjedhimisht, axhenda e Censit duhet të përfshijë kohëzgjatjen e duhur për të bërë testimet dhe përmirësimet e nevojshme përpara implementimit në terren.

9.3 Infrastruktura e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) për CAPI

9.3.1 Sinkronizimi i të dhënave dhe infrastruktura e serverave

Mbledhja e të dhënave nëpërmjet paisjeve elektronike lejon transmetimin e të dhënave nga vendndodhje të largëta gjeografike në bazën qendrore të ruajtjes së të dhënave nëpërmjet rrjeteve jo-kabllor ose celulare. Transferimit i të dhënave ndërmjet paisjeve elektronike nga terreni në serverat qendror (ose Cloud), i referohemi si sinkronizim.

Për sinkronizim nëpërmjet internetit, kërkohet një server qendror. Në varësi të kapaciteteve të aplikacionit CAPI, mund të përdoren tre tipe serveri:

- **-Cloud-based service:** Shërbimet i bazuara në cloud mund të implementohet. Kjo do të kërkonte ngritjen e një llogarie në shërbimin cloud.
- **Web server:** për të përdorur sinkronizimin me internet, kërkohet një server që është i lidhur me një software aplikacioni në web. Serveri mund të vendoset: në një sistem on-site në zyrën qendrore, që ka qasje në internet, ose në një ofrues shërbimi web (hosted websit) ose në një server virtual në cloud.
- **Serveri FTP:** Disa aplikacione CAPI mund të sinkronizohen me një server FTP (file transfer protokoll) për transferimin e të dhënave. Ky opsion kërkon një llogari të konfiguruar në këtë server FTP.

Për sinkronizimin, shërbimin cloud-based duhet të konsiderohet si opsioni i parë, për të evituar nevojën e konfigurimit të një serveri për sinkronizim në INSTAT. Për këtë, bisedime paraprake janë bërë me Komisionerin për e Mbrojtjen e të Dhënave Personale

(AKMDP) dhe me Agjencinë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI). Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave iu kërkua nëse përjashtohet përdorimi i një sistemi cloud për mbledhjen e të dhënave të cens. Përfaqësuesi i komisionerit shprehu mendimin se nëse serverat cloud janë në territorin e Shqipërisë/BE dhe nëse aksesit në të dhënat është i kontrolluar dhe i sigurt, nuk ka asnjë kundërshtim për përdorimin e shërbimeve cloud nga një ofrues publik ose privat.

AKSHI u konsultua nëse mund të ofronin shërbimet cloud që nevojiten për cens, me një hapësirë prej 1Tb dhe me një lidhje interneti të dedikuar, me bandwidth 1 Gbit/sec. AKSHI u shpreh pro mundësisë për ofrimin e këtij shërbimi nëpërmjet një kërkeje institucionale.

Pavarësisht nevojës së INSTAT për të implementuar një shërbim cloud-based, është e domosdoshme vendosja e një serveri dedikuar cens, si dhe një server reserve (backup), për redaktimin, kodifikimin dhe tabulimin e të dhënave. Këto servera mund të përdoren gjithashtu për sinkronizim, në rast se shërbim cloud-based nuk mund të implementohet. Do të ishte efikase për INSTAT, të zgjedhë një server të dedikuar për cens që mund të integrohet lehtësisht me infrastrukturën e re TI të INSTAT. Për momentin, INSTAT është në proces prokurimi të tre serverave të rinj dhe një serveri rezervë për modernizimin e infrastrukturës aktuale të TI. Specifikimet teknike të serverit të dedikuar për censin dhe të serverit rezervë përfshihen në Aneksin 2.

9.3.2 Transferimi i të dhënave me CAPI gjatë punës në terren

Transferimi i të dhënave duhet të mundësojë sinkronizimin nga tableti i anketuesit direkt në selinë e INSTAT-it dhe duhet të kryejë dy detyra. Së pari, duhet të transferoj automatikisht çdo rast të përfunduar në bazën qendrore të të dhënave. Së dyti, duhet të përditësojë aplikacionet CAPI në terren duke shkarkuar versionet më të fundit nga serveri. Në këtë mënyrë, modifikimet e aplikacionit nga zyra qendrore mund të shpërndahen lehtësisht tek numëruesit t në terren.

Aplikacionet e CAPI duhet të sinkronizojnë skedarët e të dhënave në nivelin e pyetësorit, duke rregjistruar rastet që janë shtuar ose përditësuar dhe duke transferuar vetëm rastet që janë të reja, ose janë modifikuar që nga sinkronizimi i fundit. Kjo redukton ndjeshëm sasinë e të dhënave të transferuara dhe për rrjedhojë zvogëlon gjerësinë e rrjetit dhe koston e transferimit të të dhënave nëpërmjet rrjetit celular.

Pasi anketuesit të kenë përdorur sinkronizimin për të ngarkuar të dhëna në server, një mekanizëm menaxhimi i lidhur me aplikacionin CAPI mund të përdoret për të shkarkuar dhe ri-shikuar pyetësorët në pajisjen e supervisorit. Në të njëjtën kohë, të gjitha të dhënat në server mund të shkarkohen në një skedar të vetëm të të dhënave që mund të përdoret nga Njësia e Cens në selinë e INSTAT-it për të monitoruar mbulimin në terren dhe cilësinë e të dhënave.

